ITE TIT
P1
94D

ASDREN

ENDRA E LOTE

VJERSHA

S. Arh. 46

Êndrat e lotet
s'venë kot n'erë,
Kanë e ato gjuhë
flasin shum' herë.



BIBLIOTEKA ANTIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BUKURESHT

HTYPESHKRIMI «GUTENBERG» ... R DOAMNEI 20

1912.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Së ndershmes
edhe shpirt-madhes
Zonjëze

EDITH DURHAM

si shênjë nderi edhe venerimi
për veprat e saj
me shkrime e me punë
që i solli kombit Shqipëtar
i a dedikoj këtê mundim të vogël.

AUKTORI.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

ZONJËZËS

EDITH DURHAM



Një komb i tërë o Zonjëzë të falet
Një komb i tërë nder Ty sot të sjell,
Prëj mirënjohje zêmra nuk'i ndalet
Por lutje ngreh me lott për Ty në qiell.
Për ndjenjat q'i ke, zêmrën aq' të naltë
Për ngjalljen e së ngratës Shqipëri;
Qofsh e bekuar, Zoti i Math të faltë
Për fatin t'onë, rrofsh sa malet Ti.
Me pêndën e me fjalën si ar kulluar
Me shpirtin T'ênt fisnik plot njerëzim,
Për ne si një êngjell qiellit je e dërguar
Të na shërosh nga plagët pa mbarim.
Së largu fati i kombit Ty të solli
Për vojtjet e durimet që po heq —
Fatbardhë qênka nêna që të polli
Për nè si dorë ndihmë në të keq!
Pra, priti urimet na që po t'i sjellim
Plot mirënjohje e zêmër-bardhësî,
Me lutje drejt prej shpirtit t'i përcjellim
Ty Durham „alma mater" pa kufi!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Disa fjalë përpara

Pas tetë vjet si botova të parin vëllim vjershash nënë titullin „Reze Djelli" sot po vij përpara Shqipëtarëve me një tjetër vëllim nënë titullin „Endra e Lote".

Vërtet se shkoj si mjaft kohë gjer sa t'a sjell këtê të dytin në dritë, kur lypsej që, gjer më këtê ditë të kisha vajtur ca mê tej, dua të thom, se për një që i ndjek levizjet kombëtare, nuk' êshtë mjaft që të hidhesh në fushë të luftës me fjalë për çvillimin e një ndjenje mëndore, por êshtë nevojë të ndjehesh se bên gjê e të dëftosh me vepra se vërtet e gjyrmove udhën, edh' i vajte qëllimit pas, me atê dëshirë që e nise.

Shkaku i kësaj mos përkujdesjeje që çfaqet ndë natyrë të ç'do Shqipëtarit, e ka mburimin edhe vjen prej shtetit të edukatës s'onë së remë, — që kemi vajtur përjithërisht nga dalë, — edhe kjo edukatë e formuar qishtu si ç'e dimë të gjithë, po thuaj si e pa qênë, me mos dalë a me mos patur një arësim kombëtar; po të helmuar me prallat e propagandave të huaja, ishim edhe jemi lêne por si ajo anija pa timon në mest të valave, duke u-përpjekur vetëm me sa fuqia e zêmrës na permeton ët bêjme, po gjithënjë me shpresën të rênjosur se pas mundimet e vogla të sotçme, nesër do të jemi të lumtur

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHQIPTARE "M. FRASHËRI"

të shohim se arësimi ynë kombëtar mori udhën e përparimit për një edukatë të vërtetë, duk' e ndezur flakën në dritë të së cilës do të ndritohen gjeneratat të paskëtajme që t' a nxjerin anijen në liman të shpëtimit.

Mirë po, ndokush do të thotë, se këtô çvillime me shkrim sot janë të kottë se nuk lypset të humbasim kohën me fjalë nër libra e gazeta, por lypset punë duke shetitur katunt më katunt mal më mal e breg më breg për t' i sjellë fitim qëllimit! Përgjegjia është se shkrimi ka vlerën mê të madhe për një vepërim të këtillë, se vetëm që kur dolli shkrimi u bê têrë kjo manifestatë kombëtare q'e shohim sot.

Pik së pari të dëshmojmë të vërtetën se çështja si edhe letrësia shqipe ishin edhe janë një çështje e lidhur sot për sot — sepse dihet se më ç' do komp fillimi i ç' do levizjeje të shoqërisë është bërë duke vajtur dora dorës letrësia me politikën; se duke e shtyrë njëra tjetrën, mbushen dëshirat e të dy palëve, edhe pastaj si mbaronen atô që ishin për t' u bërë, mer si cila udhën e saj veçan — po për ne, këto, do me thënë, përparimi i çështjes kombëtare si edhe çvillimi i një gjuhe letrare e kanë rugën të shtruar jo me lule, po me gjëmba, prej ato që jo t'i shkelësh a të mos u a ndjesh thumbin; por janë gjëmba që s'munt të bësh një çap pa mos vûnë 're se ku duhet të shkelësh ku t'a vësh këmbën që të mundësh t'a bësh atê çapin me siguri duk' i larguar gjithë ndalimet e pengimet—që dihen prej sicilit do atdhetar—e të dalësh majë bregut ku qëllon të ngjitesh e ku të shpie ideali yt.

Vërtet se ky ideal i ndjekur prej kohe vetëm me shkrime nga ana e kombëtarëve Shqipëtarë, ishte po thuaj si një êndrë që i ushqente disa veta, por profetia e tyre nukë dolli prap' e remë, se fara që u mbuall nuk' râ mi dhè të shterpë, ato ideera që i mundonin e që i predikonin

BIBLIOTEKA PUBLIKE UNIVERSITARE SHKODËR

atà idealistë pak nga pak zuri të bêhet një brumë e të marë një formë tjetër e cila për ditë që kalon po çfaqet në shesht me mê tepër fuqi, për t' i mveshur mejtimet e tyre me robën e vërletë të realitetit ; êshtë një evollutë a përndryshim përparimi i natyrëshmë q'e mori udhën e tija edh' i cili e shtrëngon ç' do atdhetar të jetë në dëtyrë të tij gjer sa të mbushet.

Çështja shqipe duke marë sot një sulm të ndjerë, aqë sa Shqipëtarët sot për sot janë në një tjetër shtet ndjenjash kombëtare de sa ishin tashi s' di sa vjet, e po sa vete këto ndjenja janë duk' u shtuar e duke përparuar, ashtu edhè gjuha bashkë me letrësinë kanë marë prap' atê sulm që e bên ç' do gjê që êshtë në ritjet e sipër. Si ç' duket êshtë një fakt i pa-mohuar se letrësia ka vepërimin e saj përmi shtetin shoqëror e politik te një kombi, se ajo êshtë fryma që e ngjall edhe bruma që gatohet për t' e ushqyer e për t' e ritur mëndarisht, për t' i dhënë formën e vërtetë edhe fundin e ndjenjës së një ideali të ëndëruar.

Nër aqë breza sa u-përsëritnë që kur se ndodhet kombi Shqipëtar n'atê vênt të dashur të tij, munt shumë qenë nër atà që ëndëronin një ideal t'atillë si ç' e kupëtojmë nè sot; por ishte një leth një mur i fortë që s' mundnin t'a kaptonin për tej, ç' do që të bênin për t' i harrirë qëllimit edhe idealit që ushqenin në mêndje e në shpirt të tyre, sepse qè një punë pa funt e pa themel, s' kish ku të pshtetej përpjekja e tyre, se për luftën q'e kishin nisur u mungonte një armë, edhè kjo armë që: pênda, shkrimi i gjuhës!

Por edhe në tfaqej ndonjëherë nga një shpirt-nâritur, mjerisht ky nuk' mundi as fare të arjerë prej thelbit të farës që mbillte, nje drû me pemë të êmbla ; se duket, n' atê kohë kur çvillimi i ndjenjavet fetare ishte në lulëzim të tij, ndjenjat kombëtare s' e kishin vêndin, si

BIBLIOTEKA KUBLI "MARIN BARLETI" SHKODËR

për të gjithë kombet që ishin të vdekurë edhe që u ngjallnë. Nër atô kohë të para ishte ajo luftë midis kishravet, që cila të fitoje kryesinë në botë, bênin ç' t' u mundej për t'i ushqyer atô ndjenja fetare, duke mbetur në radhë të fundit, a s' kujtohej fare, kombësia. Si u-hoth pastaj këtej edhe feja islame, vêndi ynë pati mje-rësinë mê tepër se ç' do të tjerë, të bjerë atje tek ndo-dhet sot, duk' e mbytur edh' atê të paktën ndjenjë për një qëllim kombëtar, gjer sa koha edhe rasjet e suall që t' a gjejë veglën me të cilën por si me atê shkopnë magjik të Qirqes t' u dëftojë Shipëtarëve rugën e vër-tetë, t' u provojë me gjuhë të gjallë e të shkruar se feja nuk' êshtë përveç se vetëm një ushqim për shpirtin, kur gjuha êsht' ajo që e çquan njerinë nga ngjamësit që e rrethojnë si një komb të veçantë, ajo gjuhë që duk' e folur e duk' e shkruar mirë, zêri i saj bên të buçasin malet, të ushtojnë pyllet, të murmurisin mburi-met, të ligjërojnë zoqtë, të tunden fiset, e të ngjallen të vdekurit!

Shkrimi i gjuhës êshtë ay mrékulli, ajo çudia që bêri aqë ndryshime në çvillim të kombëve, që kanë bërë çape gjigandi në ç' do degë diturie e mjeshtërie, ay ndry-shim po bêhet, i nga daltë por i shigurtë, edhe në shtet mëndor t' onë, për cmirin t'atyre që gjer die përqeshnin me atâ që predikonin të vërtetën, duk' u ngjitur disa emëra me bisht qesharakë, kur sot për kundrë po shohim se atô emëra po u mbeten atyre për ironi të giêrravet; se e drejta edhe e vërteta nuk' vdirren as që futen ndë dhèt, se as dielli nukë ndalohet dot, por as rezet e tija s' munt t'i përmbledhë ndokush ndë thes.

Përandaj dëshmoj se mundin të ndrehen të lumtur atà që me aqë të vështira edhe mundime harrijtnë të shohin me sy të vetà frytin e veprave të tyre, edhe se

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHQIPTARE

si tempulli i ri i Kombit ngrihet madhështor, si një fortesë e pa tundur.

Nër vjershat që kanë përpara këndonjësit, disà prej syresh janë bêrë para se të prokllamohet Koshtuta, po të cilavet s'u shënova vitin; të tjera u bênë pas lirisë — le t'a thomi fjalën kështu — si pas ngjarjeve të pastajme, flas për vjershat atdhësie. Nër këto ndodhen nj'a tri a katër të adaptuara, si për t' u kënduar, se nuk' êshtë pun' e ligë që të adaptojmë disâ që munt të këndonen kur ato i përqasen qëllimit t' ênë, edhe kur dihet se Muzika edhe Arti i Perëndimit po te lërohen edhe te na, do të çporret shpejt ay gjumi edhe përtesa e Lindjes që na ka kapur e na e ka mpirë trupin edhe shtetin t'onë mëndor, sa kemi harrire në një shtazëri të pa shêmbelltë për kohërat e sotçme, që të mohojmë kombësinë, jemi bêrë shpirt-robër mê keq se atâ robërit që shiteshin në treg të Romës, po të cilit kurrë nuk' druheshin të thonë „Jam Roman".

Edhe nè duke i gjyrmuar përparimet e Perëndimit e duk' e marë atê dritën që na vjen prej asaj ane, do të jemi të zotërit t' i sjellim një shkëlqim mê të math jetës s' onë kombëtare, duk' e qëruar kopshtin t'onë kombëtar nga drizat e ferrat, që kur të ndriçojë ay dielli i bukur i Shqipërisë, lulet e këtij kopshti të çvillohen e të shëndrisin por si dhe dielli vetë.

Mars 1912.

ASDREN.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

ATDHEU

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

DRINIT

Chante la liberté, prisonnier
Dieu t'ecoute.
M. Desbordes-Valmore.

Drin o lumë, o i math lumë
Që sjell vala, gurë¦shumë;
Që shkon udhës me buçime
Dhe mbush malet me gjëmime;
Që lak anës fusha, fshatra
Kur ti rendën më të katra;
Pse je sot ti i egërsuar
Vetull-mvrojtur, zemëruar?
Vall' e ndjen ti robërinë
Që e ka mbytur Shqipërinë,
Q' êsht' e shkelur, copëtuar
Vargonj lidhur kêmb' e duar;
Nga të huajt që e rethuan
Që e prishnë q'e dërmuan,
Krejt që e çveshnë që e ropnë
Dhe e thëthijtnë gjer sa u-ngopnë?

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Që kur Zoti të ka bêre
Drin o lumë, i gjat' i gjêrë,
Shqipërisë ç' i ka ngjarë
Ti të gjitha i ke parë!
Se ç' do luftë që ka krisur
Kundr' armiqve q' êsht' e nisur
I-pè mundjet plot çkëlqime
Që përmênden si kujtime!
Atà trimat e vërtetë
Që dëftonin se ndë jetë
Kurrë s' trêmbet Shqipëtari
Që ka zêmër, gjak si zjari!
Koh' e keqe a po e mirë
Mot i bukur a po i nxirë;
Qoftë natë, qoftë ditë
Si ndë t' errët e ndë dritë;
I-ke parë i-ke dëgjuar
Kur ty pranë kanë shkuar,
Dhe kaluar dhe me kêmbë
T' armatisur gjer më dhêmbë,
Luanë e trima të pa-vdirë
Krye-lartër, zêmër-lirë!
Burrë e grua, plak e djalë
Gjith me zêmër, jo me fjalë;
Si fatosa që luftonin
Shqipërinë të shpëtonin,
Dhe të lirë dhe të mirë,
Plot me gaze, plot me hirë
Në mes tyre rronin, shkonin
Dashurinë s'e harronin!
. . . . . .
. . . . . .
Po sot vallë sot si janë?
— Krye-unjur ên' e mb' anë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Sot mê s'është ay zjari
Që e kishte Shqipëtari!
Ay gjaku që valonte
Kur dëtyra i-a kërkonte,
Me një fjal' e me një besë
Për atdhen' ay të vdesë!
Pasjen, gjênë mos kursejë
Trimërinë të rëfejë!
Sot një heshtje, një përtesë
Me një rojtje në shërbesë,
Esht i ftohur, ësht i ngrirë
Pa një ndjenjë — por si i mpirë;
Dhe nga feja i verbuar
Ron ndë t' errët i mbuluar!

Drin! që rjeth gjith shkumb' e valë
Her' i rrebtë, her' nga dalë,
Kur i turbullt', kur kulluar
Kur i qettë, kur trazuar!
Që ke parë aq' të ngjara
Dhe gëzime dhe të qara,
Nd' aqë vjete, aqë kohë
Dhe me diellë, dhe me llohë!
Kur Shqiptari i vrapuar
Për në luftët i gatuar,
Me balashin krye-lartë
Sy-kulluar, sy të kjartë,
Po dëfrente, po këndonte
Kêngë trimash kur kujtonte!
Kur bari dhe blegtoreshë,
Por si mbret e mbretëreshë,
Pranë teje shumë dëndur
Fjalë, kêngë kanë ênduar,
Kur me fyell, kur me lote:

BIBLIOTEKA PUBLIKE "SAMIN BARLETI"
S. H. KÖÇE R
BIBLIOTEKA
NR. INV. 1338
S 14146

Duk' i puthur vala jote !
Kêngë e bukur, kêngë malli
Që gjëmonte i têrë zalli,
Sa edhë qielli qeshte, fliste
Dielli, hêna rinte, priste;
Mê s' degjohet sot u-shua
Më të qarë ç' do gjê u-ndrua !
Nd' ujën t' ênde të valuar
Atje brênda ka pikuar
Loti i mêmës që ka qarë
Djem të dashur q' i jan' vrarë !
Ndë atê ujët kaq' të çgryer
Që po duket gjith' i ngjyer,
Atje brênda êshtë trazuar
Në ç' do kohë të tmeruar
Gjaku e djers' e ushtëtarit
Dhe të fundit dhe të parit,
Që për emër të lirisë
I-dha shpirtin Perëndisë;
Me mjaftim q' e dhuroj jetën
Për të drejtën, të vërtetën,
Për lavdimn' e kombësisë
Dhe për nder të Shqipërisë !

Ndal-e, ndal-e Drin vrapimin
Qëndrô pak e hith vështrimin !
Rotull teje duke i parë
Se sa janë për t' u qarë,
Viset t' ona që rënkojnë
Kur të parat i kujtojnë !
Ardhi dita pra të zgjohesh
Si mê parë ti të çohesh
Burrat, trimat duk' i mbledhur
Gjith me armët mi krah hedhur

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Të përpiqen, të luftojnë
Shqipërinë t'a shpëtojnë.
Zgjedhen, turpin që po e mbajnë
Poshtë' t' a hedhin, t' a çpërlajnë—
Sepse turp êsht një shërbesë
Për atê q'e mban me besë!
Ashtu pra emrin pagëzoje
Jepi famë lartësoje,
Dëftô botës pa të druhesh
Do se i Bardhë, i Zi quhesh!
Se lavdim për të fituar
Koha êdhe mê s' ka shkuar.
Po sot dita Drin, të ka ardhë:
Prap' të dalësh faqebardhë!!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

LUTJA E TË HUMBURVET

Zot, i Madhi i jetës Ati jynë
Që përmban gjithësinë pa mbarim,
Përpara Teje vijmë sepse Tynë
Të kemi shtyllë, shpresë në gjallim.

Me kryet të përulur kurdoherë
Ty, lutje po të sjellim dhe sot, por...
Jemi êdhe të verbër, të pa ndjerë
Për t' u njohur më mirë o Ati qiellor!

Ty ne të kemi ndihmë nat' e ditë
Dhe mirësinë T'ênde, mal që e ke,
Dërgojena, ndritona me një dritë
Sepse i plot-fuqishmë veç Ti je!

Mëkatet Atë fal-na-i kij mëshirë
Se ne pa vetëdijë jemi sot;
E ndjen zêmra edhe shpirti shumë mirë
Po s' kemi zê as gojë, s' flasim dot!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Ti prâ o Shpres' e naltë hap-e dorën
Dhe bekim na dërgô si fuqi-mathi,
Me ngushëllim na e mbush zêmrën të gjorën ;
Na mblith gjith nd' atê kopsht, gjith nd'atê vath!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

SHQIPËRISË

Shqipëri, o mêma jime
Që të kam gjithë nër kujtime
Emrin t' ênt kur e kujtonj,
Shpirt e zêmër më gëzohet
Dhe një shpresë gjithë më shtohet
Në lirî të të vështronj !

Shqipëri, o mêma jime
Lott po derth prej zemrës s' ime
Se je e tretur si qirî,
Ħap-e gjirin, ħap-i krahtë
Të të puth gojën e thatë
Me një mall e dashuri !

Shqipëri, o mêma jime
Mos ri e unjur në mejtime
Ngreħi krnet ti tashi,
Se s' mbet kohë të mejtohesh
Ardhi-dita të dëftohesh
Që ke patur trimëri !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Shqipëri, o mêma jime
Mos ji nd'aqë hidhërime
Mbaj-e nderin ti q'e ke,
Kurrë Shqahu s' ka të vjelë
Kurrë Greku s' ka të shkelë;
Kur ke burrat q'i ke le!

Shqipëri, o mêma jime
Mos rënkô ti me vajtime
Se sot koha mê s' vonon,
Dolli drita, dolli dielli
Iknë rehtë e u-kthjell qielli;
Tutje t' erri po kalon!

Shqipëri, o mêma jime
Pas një jete me durime,
Dita e mirë po afëron,
Dita e bardhë, dita e bukur
Kur dhe ti je për t' u-dukur
Nd' atë dritë që mburon!

Shqipëri, o mêma jime
Bênu burrë, bênu trime
Mos u trêmp për këtê gjê,
Kërkô dorë, kërkô ndihmë
Gjith sa jemi do të vijmë
Që të vdesim gjer më një!

Shqipëri, o mêma jime
S' është kohë për mejtime
Ngjesh-e pallën trimërisht,
Tunde krahun si qëmoti
Dëfto botës se dô Zoti:
Të rrosh vetë shqiptarisht!

BIBLOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" S H K O D E R

PESË QINT VJETE...

Shqipëri, zgjohu sot këtë dit' të shënuar
Të kremtërosh lirinë që e pate një herë,
Të kujtosh burrin, mbretin në botë të dëgjuar
Që të mburoj si luân edhe si trim i ndjerë!
Kujto-e mbretn' e shkëlqyer, që ndritte por si dielli
Që i tmeronte armiqtë sa her' derdhej mi 'tâ,
Sa që tundej nga frika tok' e dheut edhe qielli
Kur palla i vetëtinte, e t' i mposhtet s'u lâ!
Pesë qint vjete mbushen gjer sot që kur u lint
Burri që të dha ty emër, që të dha fam' e nder,
Pesë qint vjet që kur po robëria të bind:
Armiku që kur të shkel dhe gjakun që t'a mer!
Oh, vjete shum' të rênda, vjete mjaft, pa mbarim
Shkuan që kur se trimi të la o Shqipëri,
Varfëria t' hipi, të mundon pa pushim
Se armiqtë të dërmuan, t' prishnë të bênë hî!
Pesë qint vjete poshtë flâmuri që kur mbet,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Shqiponja e gjunjosur që kur, rënkon me lott ;
Me mallëngjim vështron reth, lëshon zë e po thërrët
„Bijt' e mij, ndihmë, ndihmë ! mos rini kështu sot.
Po dëftoni-e një herë at' trimërinë t' uaj
Si nër luftë e dëftonte ay Trimi zoti im,
Që kurrë nuk' duronte të shkelë këmb' e huaj
Po e mprapste e dërmonte pa pikë përdëllim !
Unë kështu të dergjem, të vuaj mos më lini
Dhe ju të jini robër, për të huaj të punoni,
Mos e kijni të ngushtë zêmrën në turp mos rini,
E mjera do të shuhem, e kot do t' më kërkoni !
Po merni-e prap' atê flâmurin të bekuar
Armikut çpërbleni-ja të ligat q' u ka bêrë,
Që të jini të gjithë me zêmrën të qëruar :
Të quhi vërtet, bijt' e Skënderbeut që të têrë !"

. . . . . .
. . . . . .

Pesë qint vjete mbushen sot dhe detyrë kemi
Me shpatën tij në dorë botës na t' i provojmë,
Se këtê vênt ku hapmë sytë edhe ku jemi
Esht vêndi ynë edh' as një pëllêmbë s' lëshojmë !
Po do t'a mprojm' se mjaft të këqija duruam
T' këqija shëkullore që s' i duron as dheu,
T'i dëftojmë kujtdo se qëllimin s' e ndruam
Po do t'a bêjm' ashtu si e kish dhe Skënderbeu

BIBLIOTEKA PUBLIKE
MARIN BARLETI
S H K O D E R

BETIMI MI FLAMUR

Hymn patriotik

Keth flâmurit të përbashkuar
Me një dëshir' e një qëllim,
Të gjith atij duk' j'u betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk' frikohet
Po vdes, po vdes si një dëshmor!

Në dorë armët do t' i mbajmë
Të mprojmë atdhenë me c' do kënt,
Të drejtat t'ona ne s' i ndajmë ;
Këtu armiqtë s' kanë vënt.
Se Zoti vetë e ka me gojë
Që kombe shumen përmi dhê
Po Shqipëria do të rojë ;
Për 'të, për 'të luftojmë ne !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

O flâmur, flâmur shênj' e shênjtë
Te ty betonemi këtu,
Për Shqipërin' atdhen' e shtrênjtë
Për nder' edhe lavdimn' e tû.
Trim burrë quhet dhe nderohet
Atdheut kush i-u bê therror;
Për jet' ay do të kujtohet
Mi dhet, mi dhet si një shënjtor!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

NË MËRGIM

Lmërguar prej shtëpisë
Prej atdheut vëndit t'im,
Kur agimi i djalërisë
Zu ndriçonte me shkëlqim ;
Aty lark i mallëngjyer
Por si murgu në shkrettî,
Po mejtonem zêmër-thyer :
Vall' a kthenem përsëri !

«Ti moj shpesë udhëtare
Që përpjetë fluturon
Me vrapim, që s' lodhesh fare
Nëpër viset ti ku shkon ;
Ecë, ecë shpesë e lirë
Që më dukesh sikur flet,
Dhe një lajme sill të mirë :
Një të «falur me shëndet» !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATLIU" SHKODËR

Detëtar, o trim o burrë
Nëpër valat që këndon,
Dhe nga deti s' druhesh kurrë
Kur fryn era edh' e trazon !
Ecë o djalëth i gëzuar
Ndë atê anë mb' atê vis,
Sill një lule të bekuar
Nga ay vênt si paradhis !

Edhe ti ylli i mëngjezit
Qi shesh ditën kur mburon,
Që ke qênë bres pas brezit
Ylli i bukur që ndriton ;
Si kandile e pa shuar
Që ndë jetë s' ka shtërrim,
Dërgo-i dritë të uruar
Atij vêndit dheut t' im !»

Shqipëri, o vênt i bukur
Fusha e male plot me ar,
Ku ç' do burrë në të dukur
Eshtë trim e luftëtar ;
Me sa mall e sa dëshirë
Atê ditë po e pres,
Që edhe unë atje i lirë
Pranë prindërve të vdes !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

GJENDJA JONË

Heth vështrimin nga lint dielli:
Shum' i mvrojtur qênka qielli

Gjith ashtu nga perëndimi
Per as pikë s' ndjenj gëzimi.

Te Tomori lart u-ngjita
Po me fiikë prapë zbrita;

Që nga mali gjer te deti
Vêndi i shkretë kudo mbeti.

Që nga mali gjer nde fushë
Nëpër driza gjith u-zushë.

Kudo vajta, kudo hyra
Gjith të ftohtë nga fytyra!

S' pashë burra, s' pashë njerës;
Vetëm grat' i fisnin erës!

BIBLOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Dhe të paktit që un' i gjeta
Tërë dridhesḥin si fleta !

Sipër gjëmë, poshtë shkretë —
Si të thom s' di as unë vetë.

Trimat shkuan e më s' janë
S' di ç' u bënë, s' di ku vanë.

Reth armiqtë po afërohen
Dhe ndë vatrët po na shtrohen,

Pa pyetur e pa ftuar —
Si ca ujqër të urëtuar !

. . . . . .
. . . . . .

Burrani o Shqipëtarë
Trima burra luftëtarë

Këtë turp, këtë shërbesë
Mos e mbani *besa e bes*[illegible] !

Mos u lini mos duroni
Kështu jetën ju t'a shkoni ;

Tërë bota të na qeshin
Të na hanë të na çveshin

Por e merni punën mbarë
Mos e hiqni kështu xvarë,

Se një ditë do të vijë ;
Dhe kushdo munt që t' a dijë:

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Kur përpara Zotit t'onë —
Si të motçmit që na thonë

Fjalë kemi për t' i dhênë
Gjyqit lartë që ka vênë.

Ne, të zotrit në mos qofshim
Punën t' one mos mbarofshim ;

Prindrit t' anë t' i nderojmë
Edh' atdhenë t' a shpëtojmë,

S' meritojmë nder të kemi
Kudo qofshim, kudo vemi ;

As mëshirë njerëzije
Po mallkim prej Perëndije !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

KRERËVE TRADHËTORË

Ju njohim cilët jini, s' êsht nevojë
T' u hapet Libri i veprave të bêra,
Se populli i përmênt po prâ me gojë
Me kut i mat, me syt' i shêh të têra.

Se ç farë shëmbëlltyrë t' ju përqasim
Me ç' emër botës mundim t' u tregojmë,
Ne, kot si trut' e mêndjen do t' i vrasim;
Me juve e dimë, kombin turpërojmë!

Si ferrat jini, jetën q' e ndalojnë
Ç' do bim' e lule e mbytni ndênë gjêmbat,
Sa as dritë as diellë mê s' shekojnë;
As gjaku s' u levrin nër dejt' a rrêmbat!

Si bisha e malit, gjahut kur i dërdhi
As gjyrmë mê s'i mbetet në ka rrojtur;
Mëshirë s' kini, drojës ju nuk mverdhi
Për shpirtet, jetën që u a kini shojtur!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Si mjer' atà që presin dorë ndihme
Prej njerës pa mëshirë Perëndije ;
Si mjer' atà me djersa edhe mundime
Kështu që shohin çase lumërije !

Ju s' kini as shpirt as zêmër, dhembje s' ndjeni
Përpara jush kur krah' e duar ndehen,
Fytyrën, sytë më nj' anë i-u a ktheni
Atyre shpresës s' uaj që ushqehen !

Sa lott nuk janë derdhur pa shtërruar
Shtëpî, sa s' kanë mbetur sot të shkreta ;
Sa zêmra s' psherëtijnë sot pa pushuar
Therror q' u ranë krejt nên' thonjt' e mprehta !

Mëkatet shpinës, shpirtit që i përmbani
As posht në Ferr pak vênt s' ka që t' i nxêrë ;
Me ujt' e detit dot nuk' i çpërlani :
Mallkimi de t' ju ndjekë gjat' e gjêrë !

Prej gurit zêmrën ju sikur e keni
Që as pak s' e ndjeni qarjen e rënkimin ;
Ju ligësit e fajet s' munt t' i mfshehni
Ç' do e keqe këtu posht e ka çpërblimin !

E lumtur êsht për besë Shqipëria !
Ka kryesî, në botë si s' ka tjetër—
Një rregull e ka lênë Perëndia :
Çel një krijes' e re prej një së vjetër !...

Për dhê u-shtrihnë shtyllat e mermerta ;
Prej rênje u prenë lisat madhështorë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Më vênt të tyre hije ka të tmerta
Dhe mi rënimet ngrihen shpirt-mizorë !

U-shuan yjtë rrugën q' e ndritonin
Sa udhëtari mê s' ka sê ku të prêhet,
Shtërruan dhe mburimet që kullonin ;
Ç' do pemë që çel, helm e hidhur bêhet !

Sot zêri i fortë i luânit mê s' dëgjohet
Që malet i përçante si gjëmimi ;
Por zê bretkosash posht prej pellgu çohet
Si kêngë zije, kêngë robërimi !

. . . . . .

Mjaft, mjaft ! se u mbush kupa e hidhërimit
Gjerprinj pushoni ! helmin tej e çporrni,
Mos dalim tej kufirit të durimit :
Që më në funt se ç' mbuallt ju të korrni !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

BESA JONË

Besa jonë është flamûri
Shënj' e lartër, yll për ne,
Themel kombit që i vuri;
Duk' u lindur dita e re.

Le t' i falemi o burra
Këtij engjëll me nderim,
Me një zêmrë të gjith „burra"
Të thërresim me gëzim.

Si shqiponjë krahëgjerë
Që mi malet fluturon,
Hij' e tija është e lerë
Shpresa e kombit kur valon!

Pra nder flamurit t' i sjellim
Si një shenjës për gjallim,
Kudo ndjenjat le t' i mbjellim
Me një besë për shpëtim.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Kësaj shênje trimërije
Ne t' i sjellim adhurim,
Dhe t' u a lemë si ç' ka hije
Bijvet t' anë trashëgim.

Atij pranë të bashkuar
Me një mêndje, një qëllim,
Le të derdhim pa përtuar
Gjakun t' onë pa kursim.

Shtëpi kishim shpellat, vrimat
As një ndihmë rotull nesh,
Rrofshin burrat, rrofshin trimat
Që na e nxuar sot ndë shesh !

Atje sipër e ka shkrojtur
Dor' e Zotit që urdhëron,
Se ne kemi për të rrojtur
Kombi i ynë s' perëndon !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

VLESA E ATDHEUT



A të dua o Shqipëri
Sa mall ndjenj e sa dëshirë,
Për ty gas e dashuri
Mu ndë zêmrë më ka mbirë.
Se për mua ti o atdhe
Je një lule aqë e vyer,
Sa nuk' gjendet përmi dhe
Shpirtin t' em për t' e ushqyer.
Qindra vjete gjith në zî
Qindra vjetësh i helmuar,
Po një vlerë pate ti
Që s' ka shêmbël s' esht dëgjuar;
Vala shkuan përmi ty
Kombe shkelnë pa mëshirë,
Po një s' pati faq e sy
Të të shohë prej dheut fshirë.
Se ke prima si më s' ka

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARN BARLETI"
SHKODËR

Se ke burra të pa vdirë,
Droja syrin s' j' a u ĥâ —
Sisën t' ênde kanë pirë!
Mos ki frikë, mos vajtô
Mos me kryet, trupin zgjatur,
Tunde krahun u forcô:
Dëftô namin që ke patur!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

PËRRALLA E PLAKUT

Plak, thuaj na, për Zotin, një përrallë
Di, prej atò që i nxjer veç goja jote,
Dëfto-na, mos përtô, të paçim gjallë;
Na bêj të qeshim, a të derdhim lote!

E njohim se ne t' rinjtë, s' dimë shumë
Sa dinë pleqtë, foshnja êdhe jemi,
Prandaj të lutemi—ndë kênt të vumë
Të na tregosh — dëtyrë do t' t'a kemi!

— Në doni bijt' e mij t' u thom një prrallë
Më parë duhet jû të kupëtoni,
Se pleqtë nuk' i kanë mênttë dhallë
Si jû që fjalët kurrë s' i peshoni!

Andaj mos thoni se s' u dua djema
Po si një plak, u thom u jap këshillë —
Ju munt t' i merni fjalët si të rrema
Por un' i njoh, si prifti njeh Ungjillë!

BIBLIOTEKA RUBIKE
SHKODËR

Dëgjoni: Ish një plakë që po lipte
Që kish mjaft bij, me nipër e stërnipër,
Për bukë vuante edh' as një s' i jipte;
Ku gjente flinte, sa dhe plehut sipër!

Mallkonte jetën, ditën që ishte pjellë
Ndaj qielli ngrinte duart nga deshprimi,
Po kurrë goj' e saj s' kuxoj të sjellë
Për djemtë, një fjal' a kuvënt mallkimi!

E mjera, dyer shum' ajo trokiti
Gjer sa j' u mërzit fare, e udhën mori,
E vajti lark, ku syri i saj i ndriti
Sa rah e vdekur, shpirtin sa e nxori!

Të bijt' e saj s' e nqasën, e larguan
U ritën pa kujdes, si kafshë mali,
Më s' dinin ç' ishin, farën e harruan
As jetën s' njihnin se kush ish q' u a fali!

Sa pun' e keqe kjo! vëllaj vëllanë
S' e njihte; grindja syte i u kish zënë,
Përçarja u kish hyrë an' e mb' anë:
Të gjith në gjak e thikë kishin rënë!

E êma edhe në mos u dha mallkimin,
Po gjyqi i lartër që s' e mfsheh t' vërtetën,
S' e ndehu dorën, s' u dhuroj bekimin
Por i dënoj gjith robër têrë jetën.

Habiteshin për vojtjen keq që i gjeti
Dhe syt' i hapnin—ishin për mëshirë!
Mi shpirtt si gur o rëndonte edh' i treti
Mejtimi i s' êmës që s' u suall mirë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Asaj pas, shpejt i ranë. fajn' e njojtnë,
U digjej zêmra, lotet u kullonin,
Por ishte von, se vêndit kur u-lojtnë
Përmi eshtrat *korbët*, «ndjesën» i këndonin!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

LULJA E VETËM

Lenë kodrat ndënë dritët
T'asaj hêne qeshëtare,
Ushëtijnë, përkëdhelen
Prej ç' do ere udhëtare.

Ndaj thëllimet plot me vesë
Rron një botë por si e shkretë,
Që ndë t'errët kërkon, lypën
Pakë dritë, pakë jetë.

Nd' atê heshtje të tmemar
Qajnë shelgjet me nga dalë,
Kur po sipër yjtë dridhen
Shuhen, ndizen palë palë.

Reze t' arta me ëmbelsirë
Çohin dritë kudo duhet;
Po një s' ndodhet e për lulen
Ndënë hijet që vdes, shuhet!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"NAIM BARLETI"
SHKODER

MALLËNGJIM

Eryn veriu nëpër lis
Fletët bijen tatëpjetë,
Dheu zu çvishet më ç' do vis
Kudo duket por si i shkretë.
Fryn, buçèt gjith me mërzi
Sipër qielli bêhet sterrë,
Borëton e bije shi
Koha ndrohet me një herë.
Sa vështirë êsht në mërgim
E lark vatrës ku je lerë
Dhe sa s' gjendesh në trishtim
Kur mejtohesh shumë herë ;
Embëlsirën ti q' e ndjen
Kur reth vatrës rinë shtruar,
Miq e prinder kur i gjen
Me pëlqim dukë fjaluar :
Trimërinë me lavdim
Të stërgjyshvet, atrit t' anë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHKODËR

Burrëritë me shkëlqim
Që i çquan an' e mb' anë,
Prralla, ndodhje pa mbarim
Edhe ç' do send që u ka ngjarë ;
Si dhe gjêrra me kujtim
A me syt' q' i kanë parë !

* * *

Fryn veriu me mërzi
Si një tigër i tërbuar,
Përfshin udhës me fuqi
Duke tundur e rëzuar.
Dhe të ftohtët shpejt e sjell
Kohja e dimrit vjen e mprehtë,
Rehtë mblidhen lart në qiell
Dbora bije poshtë e qettë.
Dborë, dborë pa pushim
Kudo dheu zê e mbulohet,
Në të bardha me shkëlqim
Si një vashë mvishet, ndrohet.
Un' heth sytë me kërkim
Dhe shoh flokët si po bijen,
Duke mbetur në habim
Si po shoshen, si po shtrihen!
Kur këtô rri e i shëkonj
Ah, sa mall s' ndjenj për here,
Kur lark vatrës unë rronj
Dhe ku ndjehem aq' i mirë.
E me mêndjen gjith' atje
Shkojnë ditët, shkojnë netet,
Duke parë s' do përse
Shpresa e ime si po tretet !

* * *

Ah, sa shumë e êmbël je

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

Tin' o moj vatrëza e ime;
Edhe sa êndë, shije ke,
Sa pëlqime e sa gëzimę!
Shoh shkëndijën si kërcèn
Duk' u dredhurë përpjetë
Dhe mu si ari që shkëlqen
Aq' e vogëlth edh' e qettë.
Sa pëlqime nukë ndjenj
Kurdoher' që më kujtohet,
Që s' munt kurrë t' a dëftenj
Zëmra e ime sa gëzohet.
Ty kur unë të përmênt
Gjithënjë më vjen dëshirë,
Për ty vatrë për ty vênt
Zêmra mua m' êshtë nxirë.
Sa kujtime ti nuk sjell
Sa mall, lote për atdhenë,
Ti sa dhembje nukë pjell
Dit' e natë që s' të lenë!
Në më mundej oh, atje
Ku kam fis e ku kam farë,
Të mbaronja në atê dhe
Q' e kujtoj gjith duk' e qarê!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

BALASHIT



balash. o bukurosh
Qe je trim si një fatosh,
O dragua kali jim
Që po pret me pa durim ;
Në ke mall për Shqipëri
Ngjeshu kalë ji gati.

Shih sa vënt plot bukuri
Ku del ar, ku del flori,
Ku ndrit dielli me shkëlqim
Dhe qesh hêna me pëlqim ;
Si në vënt të prrallave
Trimave dhe pallave !

Ku një pyll, ku nje mbrekim
Male e fusha pa mbarim,
Me lendina plot magji
Ku dreth kêngë trimi i ri,
Ku del zâna për mëngjes
Lule thurur gjer në bres.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" KODER

Shpjer-më, shpjer-më o balash
Si hark rugën drejt t' a mbash ;
Çili kêmbët mos u-drô
Shkëmbinj, kodra m' i kaptô
Malit lart t' i ngjitemi —
Jemi trima e s' vritemi !

Tin' i shpejttë plot fuqi
Unë burrë trim i ri,
Kur armiku ne na del
Shqipërinë për m' e shkel
Si luân t' i hidhemi
Prej tij ne mos dridhemi !

Si shqiponja me thonj, krah'
Prej zemrimit zjar qe hâ ;
Si rrufeja sa mê shpejt
Balash derdhu atje drejt
T' a rëzojmë posht mbërdhê
Mê, mos shkelë ndë atdhê :

Sepse armiku ku u bê hî
Atje lule ka me mbi,
Dhe ku kêmba na ka shkel
Trëndafili ka m' u çel ;
Pika e djersës ku q' u derth :
Kurrë bari s' ka m' u mverth !

Faqebardhë që të dy
Do të jemi për do sy,
Kur të shohin më ç' do mur
Një shqiponjë një flamûr ;
Dhe të thonë pa kujdes :
Shqipëria kurrë s' vdes !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

VARRI I HARRUAR

Bariu me kryet unjurë po rinte
Mi një varr afër pyllit lisi dêndur,
Lott po derthte, dhe duart fare s' ngrinte
Po rënkonte mi gurin e pa gdhêndur.

— I mjerë bari! ç' qan këtu ti vallë
Ku kurrë s' shkon njeri në mot një herë ;
Ç' zjar vallë ke, për ç' mall ti s' ngreh dot ballë
Po tretesh në trishtim, vajton pa-prerë ?

Pse mê s' të gjenj me fyellin në duar
Me kêngë, dhe të qeshur si ç' ke qênë ;
Mos ke ti nonje print ktu të mbuluar
Dash'amir a po mik mos të ka rênë ?

— Ah, qanj, se këtu gjendet e varrosur
Ajo që më dha jetën ; mashtetja e ime ;
Këtu posht râ prej plumbit e plagosur :
Mêma e dashur që m' riti me thërrime !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MANIN BALETI" SHKODER



LULEKUQEJA....

Lulekuqeja e mjera
As gjekundi s' ka shtëpi,
E shkon jetën nd' arrati
Ajo s' është si të tjera
S' ka stoli !

Fushës, kodrës del vetiu
Verës ngrohet, dimrit ngrin,
Vetë shkundet, vetë mbiu
Dke kur ckuqet, vjen veriu
dh' e përfshin.

Nëpër kombë gjith e shkelin
Vënt në kopshtet ajo s' ka,
Dorë njihme kurrë s' pâ ;
As e mbjellin, as e vjelin—
shkoj u-tha...

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHTETËRORE
"MARIN BARLETI"

Po veç ngjyra e saj si zjarri
Si një hyll që dzidzillon,
Tërë bota e imiton
Eshtë shênjë për së mbari
nga shëkon.

Ajo ngjyrë kur ze çfaqet;
Mbreti fronë shkon e le,
Njerës robër fare s' sheh
Vjen e drejta del në faqet:
si zot je.

Ajo ngjyrë nd' ato fletë
Eshtë shpresa që tregon
Një të ardhme që ëndëron...
Eshtë flâmuri yne vetë
që valon!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Lutje Zânës

Eja Zânë. mburoje Shqipërinë
Vëntlermin e uruar t' Skënderbeut,
Përsëri çel-e, tund-e trimërinë
Të derdhet për shpëtimin e atëdheut
Jep-i kuxim e zêmër të luftojë
Viset e shënjta burrërisht t' i mprojë !

At' Dhodhonën e t' âtërvet faltore
Parrajsnë q' e këndoj antikëria,
Vêndin tek lonin Nuset këngëtore
Ku pa reshtur mburonte urtësia ;
Atdheun e të aqë trimave t' shkëlqyer
Që ndë botë gjith burra lon' dëftyer !

Atje syri i armiqvet u ka mbetur
Me lakmim sot përpjetën t' a përfshijnë,
Jetë, shpresë më até e kanë mpshtetur
Po si ujqet t' uret rotull gjith i vijnë ;
Se për 'ta Shqipëria është ylli i artë
E tyre t' jetë : ja dëshir' e zjartë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHKODRËS
IMRIH BARLETI

Ç' është armiku ! Këtë po e dinë vetë —
Njerës të poshtër, vrasës, tradhëtorë
Fis i ndyrë, pa rënjë të vërtetë
Robër që na kan' qënë ndënë dorë ;
Q' edhe atë gjakun t' on' q' u dha lirinë
E mohojn', na mohojnë kombësinë !

Besimi i tyre s' është drejtësia !
Se gënjeshtrës i falen nat' e ditë ;
Tradhëtimi si edhe paturpësia,
Me mburje edhe lëvdata : ja cilësitë !
Pa turp i japin botës sot mësime
Me të lipur pastaj t' heqin fitime !

Oh, veç, në arthtë ajo e lumtur orë
Flamuri i Shqipërisë lart të dalë,
Po si dielli mi malet me dëborë
Atje ay të hapet valë valë ;
Si êngjëlli me trumbetën lirimtare
Të lajmojë përlindjen Shqipëtare !

Në arthtë, thom, ajo ditë shum' e shtrênjtë
Kur zjarmi i atdhesisë të çpërthehet,
Shqiptari për qëllimn' e tij të shênjtë
Në mundje të shkëlqyëshme të çfrehet ;
Por si byka që çduket tutje n' erë
I ka për t' i çpërndarë me një herë !

Hipur balashët, armët t' u shkëlqejnë
Me zemrim dorës duk' i tingëlluar,
Me të tepër armiqve t' u refejnë
Se sa her' dalin trimat me luftuar ;
Vetëtima, rrufeja s' i ndalojnë
Kurrë s' trêmben, as vêndin s' e lëshojnë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Nuk shuhet lehtë hylli i Shqipërisë
Armiqtë për këtë sado mundohen,
Sepse ashtu është dashja e Perëndisë
Të drejtat që i ka të mos mbulohen ;
Dhe varrin që j' a mihin atà të mjerë
Atà vet' atje kanë për të bjerë !

. . . . . .
. . . . . .

Shqipëtarë ! bij trimash të dëgjuar
Që kurrë s' e duruat robërinë,
Mos u lini sot fare të dobtuar
T' a shpëtoni nga duart Shqipërinë !
Vatrën, shtëpin' e têrë gjênë t' uaj ;
Lakmim i pa të drejtë për ç' do të huaj !

Nga malet si shqiponja trimëreshe
Suli tatëpjet' dhenë duk' e mpruar,
Edhe kurora e Zanës mbretëreshe
Si hyll mi kryet ka për t' u ndrituar !
Luanë ju qëmoti kini qênë :
Dhe si luanë të mundni u êshtë dhênë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Shqiponja me dy krerë

Si rez' e fundit, t' erri kur e shuan
Agim që çduket flakë pa të nxjerë,
U-tret si drita, reja kur e gjuan.
Si një ëndër që, një pamje për pak herë;
Harrim edh' heshtje! vjetet vala shkuan
Si hije shkoj, shqiponja me dy krerë!
Se sot me një trishtim, me zëmrën gur
Të tjerë mburren shoh me atë mi mur;

Kështu desh fati Shqipëri e mjerë
T'a qash me lote trimërin' e shkuar,
As gjyrmë mos të mbetet as pak vlerë
Kurrgjë mos kesh ti sot për t' u-lëvduar!
Hith sytë, ço-e vështrimin t' ënd pa krerë
Mi shënjën trimërije të pa shuar;
Ndë gjinjt' e tû më s' munt ti t' a shëkosh,
Po teje lark sot duhet t' a adhurosh!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

PËRPARA!

Marsh kombëtar



art Shqipëri
Ti je e zonja,
Nga lufta sot mos ndalesh;
Me trimëri
Por si shqiponja
Armiqve mos j' u falesh!
Si burr' u sul atà dërmoji
Me gjak të drejtat mproji;
Përpara shkô. përpara!

Ne bijt' e tû
Për tyn' o mêmë
Forcojmë krahun t' ône;
Që ti kështu
Në lot e gjêmë
Mos jesh për gjithëmonë
Luânët, trimat sot po presin
Me nder për ty të vdesin
Përpara shkô, përpara!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Mos kij kujdes
Mos trêmbesh kurrë
Jij trime si qëmoti,
Se sot ti s' vdes
Kur djal' e burrë
Me armë del i zoti!
E drejta shesht do të dalë
Na thot' e shênjta fjalë;
Përpara shkô, përpara!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Varrit të Skanderbegut



Varr! tek Skanderbegu fle —
Shênjë e pavdekëshme e tija,
Ti q' eshtërat i mban atje
Që i qan e tërë Shqipëria,
Pse gjith po rri ndë këtë harrim
Dhe nukë del sot ndë shkëlqim ?

Varr i bekuar vall' ku je?
Atdhen' e mjerë, Shqipërinë,
Me syt' e tua nuk' e sheh
Si nënë këmbë sot e shtrinë
Armiqtë reth e reth q' i ka;
Vargojsh e lidhur posht' si ra?

Esht koha pra të zgjohesh ti
C' i japesh zë reth trimërisë,
Të vetëtinjë përseri
Nër malet lart të Shqipërisë ;
Por si shqiponja, që me vrap
Mi gjah heth thonjtë edh' e kap!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARK BARLETI" SHKODER

Ah, varr, thom hap-u, hap-u varr
S' di si duron duke pushuar,
Dhe nuk' e nxjer atë Shqiptar
Që aq' herë ty të ka shpëtuar
Të sulet prapë më kuxim
Të t' apë nder edhe lavdim!

Esht dita t' a përmëndësh them
O varr ndë botët i dëftyer,
Më shpejt të ngrihen pleq e djem
Edh' armët duke me i rëmbyer,
Të të nderojnë tyn' atje
Si edhe atë që brënda e ke!

Se mjaft ashtu ke që po rri
Ndë t' errët gjith duke lënguar,
Me qindra vjete në vaj e zî
I-lênë fare edhe i harruar!
Po zgjoje trimnë atje q' e ke
Të mpronje dheun e vet ku fle!

Sot êshtë dita për ty varr
Që botës t' i dëftosh së tërë
Se kurrë kombi Shqipëtar
Rob tjetrit s' i është për t' u bërë;
Po do t' luftonjë për një dhê:
Ku i madhi çlodhet Skanderbe!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

MALLI I SHKRETË

Tej për brî
Fshatit mb' anë,
Një shtëpi
Plepit pranë.

Plakë rri
Vatrës shtrirë;
Pa njeri —
Zêmër ngrirë!

Zjari s' djek
Flakë s' ngrihet,
Kêndit shtek
Ndehet, shtrihet.

Bukë s' pa
Plak' e mjerë,
Ndihmë s' ka;
Robat çjerrë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Lotet sysh
Pika rjedhin,
Shkel më dysh;
Bota e mbledhin.

Djemtë lark
Mbetur vetë,
Reth për qark:
Kêndi i shkretë !

Flet e qesh
Si një e marrë,
S' mer dot vesh
Ç' i ka ngjarë.

Djem kujton
Djem s' ka fare,
Reth kërkon...
Mbet qyqare !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BARIU I PARË

 shtë natë, erësirë
Heshẗje e thellë mbretëron,
Eshẗ një kohë e vështirë
Që ç' do zêmër e lëndon.

Kudo shkon e kudo kthehesh
An' e mb' anë gjith vajtim,
Kudo shkel e kudo ndjehesh'
As gjëkundi s' ka gëzim.

Për një herë di ç' vështrohet
Qielli zu po llambaris,
Poshtë një êngjëll po lëshohet
Duk' u ndrequr mi një vis.

Vise, dete duke shkuar
Te Tomori drejt qëndroj,
Dhe me syt' duke vështruar
Shqipërin' e qerthulloj!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER

Qe atje sipër u-dërgua
Me një lajme plot gëzim,
Për t' e ditur burr' e grua
Gjindja e tërë pa ndryshim.

Buzë qeshur ku që kthenet
Erësirën e mërgon,
Edh' i lumtur ay ndjenet
Dritë poshtë kur shëkon.

Dhe kur drita aq' e pëlqyer
Po shëndritte nd' hapësi,
Yjtë, hêna duk' u kthyer
Vêndit mbetnë me habi.

— Porosi prej Perëndije
Kam t' j' u thom me ngazëllim,
Sot një shpres' e re u bije
Për t' u ndritur në gjallim.

Vetë Zoti më ka çuar
Qe t' u a sjell këtê gëzim,
Sepse dita e bekuar
Për ju gdhihet plot çkëlqim.

Djathtë, mëngjer kështu foli,
Shqipërinë si e bekoj;
Roftë roftë, tha, Fan Noli
Dhe lart prapë fluturoj!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

ΤΗ ΜΗΤΡΙ ΑΛΒΑΝΙΑ



αῖρε, χαῖρε Ἀλβανία
Πατρὶς μήτηρ προσφιλὴς,
Ὡς ἐσένα οὐδεμία
Δὲν ὑπάρχει ἐπὶ γῆς.

Γῆ γεννέτειρα ἡρώων
Γῆ ἀρχαίων Πελασγῶν,
Καὶ ἀνδρείων καὶ ἀθώων
Ἡμιθέων εὐγενῶν.

Ἀλεξάνδρου τοῦ Μεγάλου
Ὡς καὶ Πύρρου ὦ πατρὶς,
Ἐσὺ εἶσαι ἄνευ ἄλλου
Ἀλβανία προσφιλὴς.

Πατρὶς τόσων ἀδαμάστων
Βραχιόνων ἰσχυρῶν,
Ἀετοὶ μὲ τὰς ὁρμάς των
Ποῦ ἐφόβουν τὸν ἐχθρὸν.

ΒΙΒΛΙΟΘΕΚΑ ΒΙΒΛΙΚΗ
"ΜΑΡΙΝ ΒΑΡΛΕΤΙ"
SHKODER

Ἄλλοι χρόνοι καιροὶ ἄλλοι
Φαῦλοι φίλοι χαμερπεῖς,
Σὲ φθονοῦν διὰ τὰ κάλλη:
Εἶσαι ὀνείρων των ἐλπὶς.

Ἠλλοιώθη ἡ ἱστορία
Οὔτε κλέος, οὔτε φῶς,
Παρελθόντα μεγαλεῖα
Κἂν σοὶ φέγγουν ἀμυδρῶς.

Ὅλοι οἱ ἥρωες υἱοί σου
Οἱ τῆς νίκης ἀετοὶ,
Μετεβλήθησαν ἐξ ἴσου
Ξένον ὄνομα ἀντηχεῖ.

Ἐχθροὶ ἄσπονδοι δολίως
Σὲ ἐνεδρεύουν ἀναιδῶς,
Ἵνα ἴχνος αἰωνίως
Μὴ σοῦ μείνῃ παντελῶς.

Δι οὓς ἔχυσες τὸ αἷμα
Καὶ ἐθυσίασες υἱοὺς,
Ἐπὶ σὲ ἔχουν τὸ βλέμμα:
Πόθους τρέφοντες κακοὺς.

Τὶ νομίζουν οὗτοι ἄρα
Δὲν ὑπάρχει Ἀλβανὸς;
Τοῦ Σκεντέρμπεη ἡ φάρα
Ἂρ' ἐσβέσθη ὁλοτελῶς;

Πῶς ὁ λέων ἐκοιμήθη
Ὕπνον νάρκης βαρυτάτου
Ἐψυχράνθησαν τὰ στήθη
Δὲν αἰσθάνεται παλμούς;

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Νὰ ἐγήρασε βεβαίως
Ἤ ἐχάθη ὁλοτελῶς
Ὁ ἀτρόμητος, γενναῖος
Καὶ ὑψιπέτης ἀετὸς;

Ἔτη ἔρευσαν καὶ αἰῶνες
Ὡς βιαία ἀστραπὴ,
Οἱ σατράπαι, κηδεμόνες
Ὅλοι ἠττήθησαν ἀεὶ.

Φύγετε ἀπατεῶνες
Τόσον, τόσον σᾶς ἀρκεῖ,
Εἶσθαι πλάσματα καὶ εἰκόνες
Ἐφιάλτου διαρκῆ.

Τὶ νομίζετε πυγμαῖοι
Ποῦ φοβεῖσθε πρὸ σκιᾶς,
Ὅτι κύπτουν οἱ γενναῖοι
Εἰς γελοίας ἀπειλὰς;

Πατρὶς! θάρρος μὴ σὲ μέλῃ
Ἰσχὺν δὲν ἔχουν ποτὲ,
Τῶν ἀνάνδρων ἡ ἀγέλη,
Τῶν κοράκων αἱ κραυγαὶ.

Ἀδελφὴν σὲ ὀνομάζουν
Τὸ συμφέρον ὡς ζητεῖ,
Ἀλλ'ὡς δούλην δὲν διστάζουν
Νὰ σὲ ἔχουν ἀσαεί.

Κάτω τὸ ὄμμα σου μὴ στρέφῃς
Ἡ ἐλπὶς εἰς οὐρανοὺς,
Εἰς τοὺς κόλπους σου καὶ ἂν τρέφῃς
Ὄφεις, ἔχθρας υἱοὺς.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Μὴ φοβεῖσαι Ἀλβανία
Ὅστις καὶ ἂν εἶναι ὁ ἐχθρὸς,
Διότι εἶναι δίκη θεία:
Θεοῦ βλέπει ὀφθαλμὸς!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

ÇPËRBLIMI...



'jam lipës, as i ḫumbur e i pa besë
Në jam pa roba, sḫorti m'a ka tḫênë;
Por unë gjitḫënjê kështu s'kam qênë
E pâttë, trimërin' e kam dëftesë.

Luftova, gjakn' e derdḫa pa përtuar
Rezikun e ndalova, mbajta „valën"
M'a zgjattë dorën jû, m'a dḫatë fjalën :
Pra vij të ndajmë gjênë të fituar!"

„Kusḫ ësḫt ay që sot kuxon pa leje,
Që paqen na e tunt, na sjell ngatrime,
Na prisḫ dḫe prêḫjen, jetën plot dëfrime —
Ç' kërkon këtu i bir i asaj së veje?

O, nxireni, të ḫujë mos e lini
Të çporret! êshtë rob e s' munt të flasë,
Me sḫqelme bûniji, le të pëlcasë
Me grusḫt, me fisḫkull sḫpinës posḫt' e sḫtrini!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHKODËR

Rrëmbejeni se vjen lart na bën hije;
S' na njeh si zot, u-ngrit si valë deti —
Dhe cili i pa i mundur ne na mbeti
Që me rëmbim luani thonjt na i shtie!"

. . . . . .

. . . . . .

Një dit' e zezë ishte duke u-gdhirë
Lart qielli i kaltërt ishte bërë sterrë,
Në gjinjt' e mëmëve fëmija e mjerë
Purtekë dridhesḧin me gjak të ngrirë!

Buçisnin malet, pushkat po kërcisnin
Ushtarët shtijnin, gjaku lumë derdhej.
Përpjetë flakë ngrihej, qielli mverdhej;
Si ç' duket se pa shëmbëll gjërra ngjisnin!

Perse kjo gjëmë, ç' faj o zot çpërblinin
Të mjerët, bukën që mezî e shëkonin,
Që s' dinin se ku shkelnin as ku ronin
E pa mëshirë togje dheut po binin?

Në dhê të tyre, t' huaj ishin vallë?
Të drejtë të mos kenë atje ku rrojnë,
Po për të tjerë djersat t' u pikojnë;
Mos shohin lumërî sa janë gjallë?

Mallkim prej Perëndije kjo do t' ishte
Mëkati i prindërve q' i kishin bërë....
Më ç' do vënt tym, shtëpitë binin sërë
Mëshirë, përdëllim gjëkundi s' kishte!

Fëmijt' e gratë maj' syngjive ngrihen
Më ç' do dritare po pikojnë lotë....
Dhe gjakatart' e tërë kësaj bote
Të dehur majë Olympit zot po shtrihen!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BREGU"

Gjer sipër era e gjakut, afsh u ngrihet!
Dhe varret poshtë u duken kopsht dëfrimi,
Të ndehur „mûndësit“ mi fron shkëlqimi:
Dhe rotull s' shohin kur u çfaqen hijet!

Prej gazi t' marrët, duart po fërkojnë
Me zemrën të kënaqur shohin varret....
Po s' dinë se edhe fati i tyre mvaret
Në dor' t' atyre që sot i shqelmojnë!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Zâni i lahutës

Zâni i âmbël i lahutës
Ky âsht kânga e Malësiis,
Por si e krismej' e asaj hutës
Qi âshtë kânga e trimëniis.

Rotull malet gjith buçasin
Kur lahuta ze gjimon,
Pyllat, kodrat sikur flasin
Zâni i bukur kur tingllon.

Ay zâ q'e bân shum' herë
Zemrën t' onë me lotû;
Dhe na lotet tuj i nxjerrë
Ndjejmë shpirtin të lehtsû!

Asht nji kâng' e mallëngjyëshme
Q' âsht dërgue prej Perëndis;
Si nji dhunti e hyjnyëshme
Për gazmênd tê Djelmëniis.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

Si ndë luftë tek ushtari
Me hov hidhet tuj këndû,
Ashtu bujku dhe tregtari
Gjith me kâng ven' me punû!

Blegtoresha dhe barija
Në atê kohë të djelmniis,
Asht lahuta dhe burija
Q' u ndes zjarmin e dashtniis!

. . . . . .

Që prej Shkodrë e gjër Janinë
Që prej Shkupi e Manastir,
Ku lahuta e ka kufinë...
Zâni i saj âsht tuj na thir:

„Nâna t' uaj, nâna e ngratë
Qi me kânge ju ka rit,
Djelm, prej jush dit' edhe natë
Ah, nji *kâng* po âsht tuj e prit!"

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Tingëllimë



, s' janë trimat, burrat që një herë
Që dridhej bota kêmbën tek e vinin,
Luanë jishin, frikë kurrë s' dinin
Armikun s' e peshonin asnjëherë.

Kur flâmuret valonin nëpër erë
Me kêngë, me kurorë ku që vinin,
Me lule rugës, radhë t' gjith u-rinin
Si mûndësve, ushtarëve me vlerë!

Po sot mjaft shekulla, mjaft vjete shkuan
Te ndryshkura si palla, thika e shpata...
Ku duhet mê s' përdoren u-harruan!

Atdhe! mëkatet nuk' të janë sosur
Durô, ti ditët mjaft i ke të gjata...
Se sot shqiponja kraht' i ka plagosur!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Gjer kur vallë!



jer kur vallë o Shqipëtarë
Do t' a mbani këtê zî,
Gjer kur vallë gjith të ndarë
Me një rojtje ndë errësi.

Gjer kur vallë hij' e rêndë
Hija e zezë pa mbarim,
Do t' u rijë si një lêndë
Përmi krye pa pushim.

Hapni sytë rotull shihni
Kombet fqinj edhe mê lark:
Ju atyre pas u vini
Tok të mblidhi reth për qark.

Gjer kur vallë pra o trima
Këtê rojtje, këtê zî,
Gjer kur vallë nëpër vrima
Pa atëdhè dhe pa shtëpi!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "SAMARIN BARLETI" SHKODËR

Erdhi koha të dëftoni
Me të tepër pra ju sot,
Se s' është jetë kjo që roni
Gjith me vaje, gjith me lot!

Po së bashku pa një frikë
Plak e burrë si edh' i ri,
Derthni-e gjakun gjer më pikë
Si ç' ka nder për Shqipëri!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Të Falura

Kongresit të Elbasanit

Motto :

Songeons-y bien, l'école en or change le cuivre,
Tandis que l'ignorance en plomb transforme l'or!
. . . . . .

Victor Hugo.

Ulumtë burrave të Shqipërisë
U lumtë atdhetarëve të shtrënjtë,
Themel me nder q' i vunë kombësisë
Që mbushnë një detyrë sot të shënjtë.
Kudo ne botë shtyllë êshtë dija,
Kudo ajo shkëlqèn me rezet t' arta,
Ndriton njërinë, s' ësht si bagëtija
Po i derth në zemër ndjenja gjith te larta.

Pra kombi mirënjohës do t' u jetë;
Në Librin e përjetëshm të pa vdirur,
Me shkronja t' arta, emrat do t' i ketë
Si mirëbërës tij ka për t' u thirur!
Përpara pra, të dashur atdhetarë
Me shpresë dhe kuxim të pa shterruar,
Dëftohuni plot forcë, Shqipëtarë,
Fatbardhë qofshi, qofshi të bekuar!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRDITA" BAJRAM CURRI SHKODËR

Koshtuta.... në Shqipëri

Një diell' i ri na thonë se po lindi
Një dit' e re u-çfaq për Shqipërinë —
Dëfrim pa shêmbëll râ mi njerëzinë;
Dhe drita erësirën, thonë e bindi!

Shëkoni si shkelqèn! si dheu i têrë
Përtrin kudo me lule e gjelbërime,
Katundet e qytetet plot gëzime...
I-qofshim falë zotit q' i ka bêrë!

Kudo vështron, një gas i ka pushtuar
Të gjithë. S' mbeti vênt ngado këndime;
Lahutat e gërnetat plot tinglime
Ndë qiell të ngreh! se ç' kah e mot i uruar!

Të lumtur jemi se na erth kjo ditë
Që kurrë ne s'e prishim thom për besë,
Lum kush ka jetë, lum kush s' dô të vdesë--
Lum kush i ka të forta moshkëritë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE „MARIN BARLETI" SHKODËR

Sa mirë vemi, gjithë përparime
Vështrojmë, têrë viset si po qeshin,
Sa janë ndë natyrë roba mveshin;
Sa shohim rotull, jo, s' janë êndërime!

Po, kohа e artë ne na e mpshtolli jetën
Me dituri, me mjeshtëri sot rojmë,
Pa një kujdes ne ditët gjith po i shkojmë;
E drejta u-bashkua me t' vërtetën!

. . . . . .

Më kot nuk' u-munduam, hapëm udhë
Fituam një kurorë si të rallë...
Të gjith me gas na puthnë faq' e ballë
Një punë, po, si e vjetër por.... methudhë!

Vërtet se ne punuam me një besë;
E vumë krahun, derthmë gjakun t'onë,
Dëshira e vëndit ish dëshira jonë
Se s' di Shqiptari ndryshe si të vdesë!

Po një zakon për vet' e ka Shqiptari:
Me lajka ay gënjehet — foshnjë e mitur —
I mëntçëm bêhet, mbahet si m' i ditur;
Nër kombe thotë, se na qênkë i pari.

Të tjerët sa që ay i gjen sé janë
Të fundit, kohë s' kan' ata t' mendojnë,
Po hedhin çapin dhe përpara shkojnë;
S' ushqehen me „pilaf" e me krahanë!"

Shqiptarit s' i pëlqyeka lëvdata!....
Përvëç bën miqësi me ç' do të huaj,
Vëllamë bêhet, shpirtin jep po thuaj
Po fundi? Mbet me duartë të thata!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "SHKRINBURELI" O D E R

Kur hêna s' ish, na thotë vjershëtori
Shqiptari jishte! Me t' u bërë dheu
Të parën copë ay pra e rëmbeu
Nuk' êshtë prallë, ja ku flet Tomorri!

Ç' u bê ky vallë? Aqë shekuj rothnë
Të vdekurit u-ngjallnë, rojn' e janë,
Fuqî, vullnet të fortë atà sot kane —
Shqiptarit si, virtyte nuk' j' u-ndothne!

Vërtet kështu kjo munt edhe të jetë:
Të gjitha mplaken, vdirren pa dhe treten;
Veç thrime, gjyrma e shtrembësira mbeten:
Natyra êsht pasqyra e vërtetë!

... Po një ndryshim êsht si çudi mos m betet
Të Skënderbeut kush mban hajmalinë,
I trashëgon si ç' thonë trimërinë
Pra duket se s' e vdirrin kurrë vjetet!

. . . . . .

I mjerë atdhe ti Shqipëri e bukur
Që die posht' e shtrirë psherëtinje —
Luân i përgjakosur — kryet s' ngrinje
Fytyra madhështore t' ishte e çdukur!

Pluhur' i zisë nata t' kish mbuluar
Tirani i lik s' të linte as të ngrihesh,
E lidhur, e përmbysur pa të njihesh
Një trup me shpirt, pa kêmbë edhe pa duar!

Durove, u-lëkunde posht e rrzove
U ngjalle por si trimëresha e prallës,
Me një rëmbim, një mbyllje të qëpallës
Këpute hekurat, gjallimn' e ndrove!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Po sa prej nje tirâni ti shpëtove
Mezî shkëlqyen rezet e lirisë,
Atë liri mi trup të trimërisë
Që ti me gjak e mprojte, e pagëzove,

Të tjerë t' ardhur s' di se ku nga ç' anë
Të mveshur me lekurë dele-butë,
Me ndjenja t' egëra por si hajdutë
Me lajka, me premptime ndenjnë pranë!

Nevojë kishin sipër sa të dalin
Dhe si shpirt-liq ty çpagën që të japin....
Një grusht mi qafë, burgjet po t' i hapin:
Atje ti ke të drejta.... tek t' i falin!

Të drejta? oh, vërtet këto q' i japin
Kujt do të ardhur, kujt q' u zgjati dorë.
Ty pa mëshirë të ndjekin si mizorë;
Si komb s' të njohin, ty të kllasin drap'in!
. . . . . .

I varfër popull kurrë nuk' t' pyesin
Në je i ngrênë a po në je ti i mveshur,
Në, syt' e buzët ty të kanë qeshur
Fëmijt' e tu për bukë n' mos të vdesin!

Paguaju me gjakn' e djersën t' ênde
Punô, se ti ke forcë ta i trashë
Ti jetën nuk' e shkon me «thën e thashë»
Ti je si bagëti në t' tuat vënde!

Ty shpinën le t'a pjekë vap' e diellit;
Ti derdhe djersën të vesojë dhenë,
Më gjunjë kryet unjur mbaji frenë:
Se ky për ty ka mbet bekim i qiellit!

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKOLLORE "MARIN BARLETI"

Një varr për eshtrat t' tua nukë ndodhet
Të shkretat tin' i ke ngado lark lënë,
Ty veç se arratisë s' të është dhënë;
Dhe trupi i yt pak vënt s' ka ku të çlodhet!

Të huajt shih si po t' qytetërojnë!
Kudo po çelin shkolla diturije,
Nër gjithë viset ruga tregëtije;
Ndë *Lindje Perëndimin* po e çojnë!

Ndë gjuhë t' ënde folë e shkruaj shumë:
Për qiell, për yj, për dhenë sa të duash,
Po për të tjera mos e zgjat, t'a ruash
Se ja gërshëra thonë, dhe.... ndë lumë!

— Si jo një komb fatbardhë ne po jemi:
Kur lypim dituri, na kthejnë krahtë
Donjë të drejtë... koha është e gjatë;
Po thamë gjë... përpara topnë e kemi!

Po kur ze qielli nxihet, reht' gjëmojnë
Kur vjen furtuna q' e përmbys e dheun,
Rëkeja valë vjen t' qërojë «plehun»;
Rufetë kur kërcasin derpëtojnë,

Reziku, thom, kur vjen e i bie derës
Kur shohin se më s' kanë nga të dalin,
At' here ty „të drejta" po, të falin....
Po kockat tin' i le në funt i skterrës!
. . . . . .

„Mos na trazoni farë e fis i ndyrë
Që s' latë vënt pa prishur pa shkretuar;
Se bota gjer më sot në u ka duruar
Këtë na e kini neve ju dëtyrë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Besoni shpirt se s' kemi vdiqmë fare
U-shuam, zemra jonë u bê si guri;
Shqiponja u-plagos, u-tret flamûri
Dhe ju na ndehni dorën gjakatare?

... Mos arthtë ora, mos e sjellçin vjetet!
Se ne po i tundmë shtyllat e shtëpisë,
Të kllasim zjarr, të bëhet hî edhe pisë....
As ne, po edhe jush kêmbë mê s' j' u mbetet!!»



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

SAMI POJANIT

Nuk' di në jam i zoti
lavdime ty të t' sjell —
Atê q' e bên veç moti
për veprat kushj i mbjell.

Nuk' di në e kam fuqinë
dy radhjë të shënoj,
Sepse unë Historinë
nuk' munt që t' a krijoj.

Ç' do veprë q' êsthjtë bërë
ç' do punë me thjemel,
Ka radhjë, ka edhje sërë
në gji të dheut ku u çel.

Dëshjirën që e ushqeve
për kombin e dheut t'ënt,
Me punë ti e rëfeve
sa pênda s' më ze vênt.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Ti kurrë nuk u lodhe
prej mallit për atdhe,
Në zemrët e përmblodhe;
i fale bes' e fe!

S' ka punë m' e vështirë
kur zemra shpesh rënkon,
Për ndodhjen aq' të nxirë
t' atdheut që lëngon.

Dhe loti im sipër varrit
prej shpirti në pikon,
Ngjet si shkëndij' e zjarrit
që flagës del e shkon.

Lëvdatat pra të mija
kot venë kush kërkon...
Kê, têrë Shqipërija
e kombi e kujton!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Armët e Skanderbegut

(Në Muse-u të Vienës).



pall'e burrit, yllit te pa shuar
Të trimit shok që s'pati—një për jetë ;
Që dergjesh sot pa shpirt ; pallë e dëgjuar
O shênj' e kombit mbetur si kujtim !
Ti na përmênt luftarin, burrin vetë
Qi për atdhenë râ therror si trimi
Me tyn' i solli mûndje përshkëlqimi ;
Dhe sot rri vêndit n' heshtje edhe harrim ;

Dhe tin'o helme e tija q'e pa tyndur
Sot dukesh—ngrehur brirët gjith përpjetë,
Ti që i qëndrove kryes e pa e-mundur
Me madhështi, luftarit që mê s' ron !
Si një dragua ay ish, përpinte rehtë
Dhe syri i tij si zjarr sî trëmbej kurrë,
Fuqi kish doren, krahun, ishte burrë ;
Dhe ti sot akull je, më vênt qêndron !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

O armë plot shkëlqim, o dritë djelli
Ju që i suallt famë e nder atdheut
Në luftë gë tingllonit gjer te qielli —
Shqiponja mali mveshur trimëri!
O pallë edhe ti helme e Skënderbeut
Prej qindra vjetsh që mbani zi paprerë
Arth dita, Shqipërisë edhe një herë
Me famë t' i shkëlqeni përsëri!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

ΤΑΦΟΙ ΗΡΩΩΝ

Τὶ ἄδεις ποιητά, ἐδῶ ἐπάνω
Λὲν βλέπεις ἀναπαύονται νεκροὶ;
Πῶς, ἄσματα τῶν τάφων πρέπουν ἄνω
Ἀντὶ νὰ σοὶ δακρύζουν ὀφθαλμοὶ;
Ἀλλὰ αὐτῶν καὶ ἂν ἄδεις τὰς ἀνδρείας
Ἀγνώστους ἄδεις ἄνευ ἱστορίας.

— Ποτὲ δὲν πτοεῖται ἡ Ἀλβανία,
Τό ἄστρον της δὲν σβύνεται ποτὲ,
Καὶ μέλλον ἔχει καὶ δόξας, μεγαλεῖα
Ὡς αἱ θεοῦ ὁρίζουσι βουλαί.
Μέ τῶν ἀγνώστων τὸ αἷμα, τας ἀνδρείας
Ἀνθεῖ τό ῥόδον τῆς Ἐλευθερίας.

Λὶ ἄνδρας ποῦ δέν ἔκλιναν αἰχένα
Η ἱστορία καὶ ἂν τοὺς ἀγνοεῖ,
Ποτὲ δεν εἶναι ἄγνωστοι οἱ ἐμένα—
Τὸ ἄσμα ἀντὶ δακρύων ἀντιλεῖ.
Λέν εἶν' οἱ τάφοι οὔτοι ὄντων ἀσημάντων
Ἀλλ' εἶναι ἡρώων καὶ γιγάντων!

ΒΙΒΛΙΟΓΕΦΑ PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Zêri i Kryengritësvet

Shqipëtarëve të pasur.

Ne s'duam paqen, prêhjen që t' j' u prishim
Ne s'duam të na i falni pasuritë,
As dorë s' zgjatim—lipës s'e durojmë;
Në luftë që të veni na s' j'u grishim
Të lini laık fëmijët dhe shtëpitë!
As gjê për veten t'onë s'u kërkojmë
As gjê nuk'duam nukë
Veç armë edhe ca bukë!

Me kryet lart në zjar të luftës vemi
Dhe gratë rrokin armët na gjyrmojnë;
Me gas e derdhim gjakun për lirinë!
Rezikun s'e peshojmë ku që t' jemi
Prej zê trumbetash malet kur gjëmojnë
Të shkret' e lemë vatrën e shtëpinë!
Ju gjê s'u duam nukë
Veç armë edhe ca bukë!

Esht turp për ne t' i zgjatim botës dorë
Dëtyrë kini ju të na ndihmoni
Në i kini dhembje vetes dhe atdheut!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

Ne s'druhemi nga breshër, shî a po dborë
Po kurdoherë ju që të kërkoni;
Një tingëll armësh del nga faq'e dheut!
Pra gjê nuk' duam nukë
Veç armë edhe ca bukë!

Vëllezër, prej një nëne jemi lerë
Po fati na ka lidhur pran' t' i mbesim
T'a shkojmë jetën t'onë me durime,
Me djersë, te vështira dhe të mjerë!
Këtu në malet lart ne do të vdesim.
Për rojtjen t'uaj, jetën plot pëlqime
Âs gjë nuk' duam nukë
Veç armë edhe ca bukë!

Ju rroni nër shtëpira plot shkëlqime
Nuk' dini vojtje, lote edhe kujdese;
Të çveshur si ne, pak sot munt që t' jenë,
Si ju s'e shkojmë jetën me dëfrime
Po njerës jemi gjith t'asaj krijese;
Për nderin, vatrën, kombin edhe atdhenë:
Âs gjê nuk'duam nukë
Veç armë edhe ca bukë!

Shtëpi ne kemi shpellat, vrimat, malet;
Nesh rotull gjith armiq e tradhëtorë
Pa vëtedijë, njerës të pa besë;
Një ërgjêndit, arit tjatër sot i falet!
Kush helmin t'heth, kush shpatën mban në dorë
Dhe kush vëllan' armikut do t'ja shesë!
Për zotin, s'duam nukë
Veç armë edhe ca bukë!

Kur flamuri kuq-zi bën vala ngrihet,
Shqiponja me dy krerë kur del ballë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Kur dridhet toka, topat kur shëkojmë;
As një prej nesh at'here nukë mfshihet
Po flâmurin, të vdekur a të gjallë
Me radhë do të bijem t'a shpëtojmë!
Pra mos na lini nukë
Pa armë edhe pa bukë!

Këtu pra njihet vlera, trimëria
Këtu rëfehet forca e kombësisë.
Se ne me t' u-bashkuar tundet dheu;
I thyet ç'do armiku gjith fuqia
Çel trëndafili i bukur i lirisë:
Përtrihet kombi, ngjallet Skënderbeu.
O, gjê nuk' duam nukë
Veç armë edhe ca bukë!

Kujtônani me ç' kini pra të tepër;
Ne derdhim gjakun lumë, ju veç pasje
Ne vdekje tmeri presim, ju veç rojtje!
Se me theror fitohet sot ç' do vepër
Me njerës bêhet themeli me ç' do rasje;
Pra fshihnani sot lotet plot me vojtje
Se gjê nuk' duam nukë
Veç armë edhe ca bukë!

Ç' na duhen krahtë dot kur s' i përdorim
Ç' na duhet jeta, robër gjithëmonë
Kur s' shohim diellin, dritën e lirisë!
Pra hênën, erësirën që t'a zhorrim
Të ngjallim kombin, farën, fisin t'onë
Për nderin t' uaj ndec' e Shqipërisë:
Gjê tjatër s' duam nukë
Veç armë edhe ca bukë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Kênga e bashkimit

Ardhi dita e lirimit
Dita e bukur e bashkimit,
Mblidhuni o Shqipëtarë
Qytetarë e katundarë.

Këtê ditë të shënuar
Që prej Zotit êsht bekuar,
Ne t' a lusim t' a nderojmë:
Jetën t' onë t' a gëzojmë.

Eja Gegë këtu pranë
Qas-u, qas-u por si zânë,
Dorën zgjate me dëshirë
Si një burrë i pavdirë.

Gegë, Toskë vllazën jemi
Të dy bashkë një emër kemi
Dhe një fat në këtê botë:
Shqyptar' jemi fjala thotë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

Prej një nâne jemi lerë
Mysulman' e të Krishterë,
Më një djellë jemi ritur
Si dy lisa pranë ngjitur.

Të dy kemi një dëshirë —
Se një sisë kemi pirë,
Një të qeshur, një të qame
E një zêmër të pa ndame.

Prej Vïose gjer te Drini
Mos na ndajë dot Shkumbini,
Por si vllazën na të rojmë,
Dhe Shqypninë t' a forcojmë.

Se Shqypnia êshtë besa
Nderi i ynë jeta, shpresa,
Besën t' onë pra t' a mbajmë
Kurrë armiqtë mos na çajnë!

Veç si burra pa një drojë
Si ndë luftë edhe nevojë,
Tërë bota ka me ditur
Se na s' jena për t' u shitur.

Po të fortë e të bashkuar
Krye lartë e shpirt-ndrituar,
Të gjith kena m' u përpjekun:
Për Shqypninë sot me vdekun!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

KRUJËS

Krujë, vênt plot famë i lavdëruar
Që të adhuronte e tërë Shqipëria,
Ti je qyteti i motçëm i bekuar
Që linde trimn' e math të pa harruar!
Tek ty mburonte forca, trimëria,
Që t' u shkëlqyen emri edhe lavdia.
Je tempull feje — kishë për adhenë
Se brênda ke një korë: Skënderbenë!

Mjaft na êsht kur këtˈ emër e kujtojmë
Mjaft na êshtë kur jˈ a përmêndim trimërinë,
Aq sa kur tyn' o Krujë të vështrojmë
Na ngjallet zêmra, emrin t'a bekojmë,
Se ti e përmbleth të tërë Shqipërinë
J' a bêre të përjetëshme Istorinë:
Që mbet si shêmbëll—mburje e kombit tênë:
Si një yll që na drejton për gjithëmonë!

Por sot ku i ke ti hámmrat, dafinat
Kurorët trëndafilesh plot shkëlqime;
Ku janë kêngët, vallet nër lendinat,
Ku janë ushtritˈ e vlerëshme nër krahinat

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Që vinin gjithë me radhë plot gëzime
Por si herôjt nga mundje pa tregime;
Atà dragonjtë zêrin veç që prisnin
Me gas në më të parin hov të vdisnin?

Vall' ti je Krujë e dashur e një herëshme
Me ato fortesat, gjyrmat veç sa u-njihen,
Që janë gjithë gremina—pamje e tmerëshme
Me muret ngrênë, nxirë—shênja t' errëshme;
Ku korbër e gjërprinj për ditë mfshihen
Dhe shpesë nate, tmer në shpirt që shtien;
Ku del në vênt të kêngës zê vajtimi
Edhe në vênt të gazit lòtt trishtimi?

Po! sot nje zî, një hije e rêndë shumë —
S' të mbet as shênjë as gjyrmë madhështie,
Ç' u shojt ç' do ndjenjë; rê si gur në lumë
Sa as valat nuk të tundin nga ky gjumë!
Veç rall' e tek, një lule mbin ndën' hije
Si shënjë fare e vdekur nami e lavdie!
Se e vdekur je o Krujë e adhuruar
Sa q' armiqtë edh' emrin sot t'a kanë ndruar!

Pra o Krujë e shênjtë, ty të mbet për barrë
Atij një përmêndore të pa vdekur
T' i ngresh, te vêndi dritën ku ka pare:
Me flâmure, trumbeta edhe ushtarë
Të rahur në çelik, në ram' edh' hekur;
Atje ku Shqipëtarët duk' u pjekur
Me nder të thonë rrotull kur t' i rinë:
«Ky është trimi që luftoj për Shqipërinë!»

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARDHI" SHKODËR

KOSOVËS

Kosovë, o vëndi i fâmëshm i trimniis
Kosovë, o lule e bukur e Shqypniis!
Ti bjeshkat plot vïollca reth i ke
Si vash' e virgjën; Nuse sikur je;
Dhe malet me boor'
Mi krye i ke kunoor'!

Kosovë, atdhe i lavdume i burrniis
Ti ke pas kjen mbretnesha e Rumeliis!
Nalt mbaji kryet t'ânde si gjithëmoon
Difto-u e zonja; koha sot e don
Ti t' çohesh përsëri
N' luft' t' mbarë për liri!

Se teje, të madhe shpresë nshqen Shqypnia
Me burrat ti q' i leen, t' gjet' si selvia,
Sakola mali, shoq në bot' që s' kanë
Si luaj e si dragoj plot forcë që janë,
Që e derdhin gjakun pruë
Atdhen' për m'e pështuë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERLETI" SHKODËR

Ke bij qi s' kanë drojë as nji pikë
As syni far' s'u-tutet, s'dinë as frikë,
Anmikut kur i sulen me rrebtësii
Si breshni mi 'të hidhen me duhii
Sa bije e krye s' ngreh
Por eshtnat dheut i le!

Gra e vasha ke, si zâna sy-mbëdhâ
Trimnesha, si Shqypnia din m'i bâ,
Qi rrokin armët në luft' me gas tuj shkû
Ja se me munt, ja se me dekun tuj luftû!
Për ndeer të shtëpiis s' vet;
E falin shpirt e jet'!

Te toka jote aq' luftna janë bâ
Ku trimat preknin deken pa me qâ,
Kur nâna e motra lott derthnin pa prâ;
Atà me gjakun dheun e kanë lâ
Si di Shqyptari n' jet'
M'e bâ dëtyrn' e vet!

Kosovë o trimëneshë, lul' e rallë
Detyrën tin' e ke me dal sot në ballë,
Se mbrini koha, tokën për m'e mpruë
Anmiqt' e motçëm jashtë me i dëbuë
Se mjaft e kan' robnuë
Dhe n' zjarm e kanë pruë!

A munt m'e durue pa prâ këtë zgjedhe
Që të huejt para syvë të t' vënë ledhe,
Për me t' rëzuë nër kâmb' e për me t' shkel
Për me t' bâ gjith copë, mirë si j'u del
Dhe duursh mos të lëshojn'
Por faqes s' dheut të t' shojn'!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Ku jeni pra ju burra, ju luftarë
Kosovas, o të vlerëshmit ushtarë,
Qi keni për tân' botn luftû gjithmoon
Nër dejt vall gjaku mâ nuk ju valon
Pak ju me u përmênt
Për votër e për vênt?

Nuk shifni rotull jush, Serb e Bullgar
I flliquni ħalldup, Magjyp barbar,
Shqypniin si e mbajn nên' kâmb t' tyne nên'
[thêmrë
Si ja çpojn' syt' e faqet e deri n' zêmrë;
Duun emnin me j'a çduk:
Me dek pa ujë e pa buk!

Disa «Serbi e Vjetër» duun me i thanë
«Maqedhonii» do t' tjerë emnin j'a lanë!
Atyne si u pëlqen kufinjtë i vênë
Shqypnia veç mas dojës s' tyne me kjenë;
Mendojn' pa turp kurrfar'
Se s'ka nji komb Shqyptaar!

Përpara burra, rrokni hut' e shpatë
Prej ziis pështonije Shqypniin e ngratë,
At' nânen t' uej t' lidhun kâmb' e duur
Q' anmiqt e kan' vorruë me dhe e me guur',
Me lott qi qan e ankon
E as nji nuk' i ndihmon!

Shqyptarë, mos kujtoni bes e fee
Po nânen ju kujtoni që u ka lee,
Qi ka mbet fill e vetum si grû e vê
Prej bijvet e harrûme mi kêt dhee!
Se âsht turp i math për ju
Të huejt me i u çnderû!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Sot ora mbrini dita e bekûme
Shqypniin m' e bâ në bot' nji vênt t' lirûme!
Kosovës emnin me j' a ngref te-qilli
Për çud të botës sa ka me shkëlzyë dilli
Me rrnuë nji Shqypnii
Si zonjë në lumënii!

Shqyptarë çoni-u, vllazën ora mbrini
Si Geg' e Toskë nalt flâmurin e ngrihni!
Në Manastir, Shkup, Shkodrë e Janinë
Nji trup bâni-e an' e mb' an' Shqypninë
Si ç' trimit mir' i prek
Me nder luftës me dek!!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

CILËT JEMI!

Ku mundim na t' a njohim kombësinë
Që e dimë si atdhe edhe Shqipërinë?
Kjo është gjuha e nënës që po flasim
Si edhe zakonet na që i përqasim.
Po cila është shënja e kombit t'onë
Nga t' huajt që na çquan gjithëmonë?
Ky është flâmuri ynë shum' i ndjerë
I kuq edhe shqiponja me dy krerë —
Ay është i kuq si zjar, me gjak i larë,
Ajo e zezë, malevet ka shkarë;
Na e lane atà të parët, trimat t'anë
Për 'të q' e derthnë gjakun që u-vranë!
Po me emrin Geg' e Toskë ç' kupëtojmë
Sa herë njëri tjetrin e kujtojmë?
Një fis dëfton se jemi edhë një farë,
Një shpirt, si dy vëllezër të pa-ndarë;
Sepse një mëm' e madhe na ka pjellë
Por si dy lisa ritur në një djellë
Të dalë prej një rënje, prej një gjiri
Prej dheut ku qesh qieli e fryn zefiri;
Dhe Zoti atë q'e bëri me së pari:
Ky jemi ne, ky është Shqipëtari!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Dëshmorëve të Kombit

Për nder' e tërë Kombit, për atdhenë
Në luftë ranë trimat e vërtetë,
Që t' i këputin hekurat e frenë...
T' i sjellin përsëri liri edhe jetë!

Në botë m' i math nder as munt të ketë
Për burrat lart q' e mbajnë fjalën, benë,
Se atà shtatuj' e tempull ngrehin vetë:
Me gjak kur ckuqin flamurin e dhenë!

Në radhë të dëshmorve shpirtet t'uaj
Në prëhje do të çlodhen gjithëmonë
Si shënjtër drejt në gji të Perëndisë.

Edhe nga varret, sot q' i shkel i huaj
Ka me shkëlqyer dielli i ardhmjes s'onë:
Liria edhe përlindja e Shqipërisë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

NATYRA

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

TË KORRAT



Por si zânë këngëtore
E stolisur kênt e kênt,
Na erth vera vjershëtore
Plot me lule edhe gazmênt.

O ju vasha bukuroshe
Nisni kêngët përsëri,
Dhe me duart vogëloshe
Valles ziruni tashi.

Erdhi koha shum' e bukur
Kur të korrët mbretëron,
Têrë fusha në të dukur
Si vashë êsht që nusëron!

Yjt' e hênë perëndojnë
Del agimi plot shkëlqim,
Zoqt' të dehur ligjirojnë
Têrë ditën pa pushim.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" KODER

Këndon zogu gjithë me hirë
Tutje kali hingëllin,
Fërshëllon thellëz' e lirë
Poshtë rëkeja fishëllin.

Arat bukur zbardhëllojnë;
U-mverth gruri edhe u-thâ,
Dhe kallinjtë po rëndojnë
Kryet nkthyer më një krah!

Punëtorët që më natë
Marin draprin me vrapim,
Hollë mveshur dalin gratë
Pas u venë me gëzim.

Gratë korrin e këndojnë
Si edhe burrat me pëlqim,
Dhe me djersë gjithë punojnë
Gjer sa ngryset, pa pushim!

Korrin, korrin punëtorët
Togjet bien poshtë' mbërdhë;
Ç' bukuri që ka të korrët
Ah, sa shije ndjen atje!

Tek kallinjtë bëhen duaj
Sa më k' ênda atje të jem,
Sa mban dita n'atê muaj:
Me mall kêngës do t' ja them!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Perëndim dielli në verë

Sa pamje e bukur e madhështore
Sa magji çfaqet që s' ka mbarim,
Natyra duket më vjershëtore
Me aqë ndryshime plot me pëlqim.

Si dhisk i zjarrtë perëndon dielli
Tej reht' e malet flakë i ngjyron,
Ckuqet e mverdhet përpjetë qielli
Një zjar vollkani sikur kullon!

Si pluhur duket kur po lëshohen
Rezet e fundit me qetësi,
Dhe në kurorë të artë ndrahen
Duk' u-përhapur plot me magji.

Bredhat e lisat tunden e ndalen
Kur er' e mbrëmës është në fillim;
Por si në tempull njerës kur falen:
Përpara korës me një adhurim!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODER

Gruri, tërshêra gjith ar ngjyruar
Me pëshpërime tundet me vrap,
Lendin' e gjêrë me lule e shtruar
Erë prej afshi kudo përhap.

Lumi, përroji në fytyrë ndrohet,
Kodra edhe fusha plot bukuri;
Anës së detit po pasqyrohet:
Ulliri i gjelbër me madhështi!

Rêzës bariu si gjithëmonë
I bie fyellit gjith me pëlqim,
Nuset e vashat vjershës j'a thonë
Nëpër kasollet me përmallim!

Sa pamje e kândeshme edh'e pëlqyer
Eshtë kur dielli po perëndon,
Ah, sa êndra; shpresë pa u deftyer
S' na sjell e nesërmja që afëron!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Këndo-na bilbil

Këndo-na o bilbil i ngratë
Këndo-na bukur me pëlqim,
Ti kêngës nisja që më natë
Nër degët plot me gjelbërim.

Këndô me mall, këndô nga dalë
Prêndvera erth, prêndvera shkon,
Këndô mi fletët palë, palë
Si zêmra ty të dashuron.

As thuaj-na një kêngë zjarri
Të dredhim valle si nga mot,
Se dimri vjen e shkon beharí :
Dhe shija jote s' gjendet dot.

Këndô sa dheu që është i mblerë
Këndô sa gjethi lulëzon,
Në zêmrët t'onë mall na shtjerë
Që na përtrin, na gjallëson.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BUSHATI" SHKODËR

Bilbil, bilbil o zogth i mbarë
Ti kêngës kur j' a nis më nge,
Me zê të qeshur, zê të qarë;
Habitet bota përmi dhe!

Këndô pra dimëri sa s' ka ardhur,
Sa robën pylli s' e ka çvesh,
Se dbora dhenë ka m' e zbardhur:
Dhe zî ndë zemrat do t' na lesh!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

VJESHTA

Çduk vapa, shkojti vera
Dhe bilbili më s' këndon,
Ardhi vjeshta me të tjera
Syri i ynë q' i shëkon.

T' erret koha, hapen rehtë
Ngjyrë plumbi përsëri,
Duket prapë tjetër jetë
Që natyra ndron tashi.

Era fryn, dhe fletët bien
Pemët çvishen si nga mot,
Mali, fusha më s' ka hijen
Që po e kishte gjer më sot.

Qielli i bukur që dëfrente
Trupin t' onë, sot u t'err,
Më s' ka ngjyrën që shkëlqente:
Si pasqyrë, si mermet.

Bukuritë janë çdukur
Shiu e bryma zuri vënt,
Bari, lulet, kopshti i bukur
U-ndryshuan më ç' do kënt.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Dhe liqeni i kulluar
Që ndriçonte me shkëlqim,
E ka faqen të trazuar:
Dridhet, tundet pa pushim.

Veç nga herë me ëmbëlsirë
Dielli rezet na i dërgon,
Natën hêna me një hirë
Në ërgjênt malet i ngjyron.

Por e mirë êshtë vjeshta
Sepse bujku gjith punon;
Për të vjelur sot ka vreshta
Nesër arat po lëron.

Njerëzia nga ç' do anë
Po sa ngrihen në mëngjes,
Nëpër fushë ç' do që kanë
Rendin, mbledhim me kujdes.

Pra me punë gjith të rojmë
Se veç puna ne na vlen,
Sepse ndryshe s' trashëgojmë
Verën tjetër që po vjen!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Shpesët udhëtare

Tok mbledhur si nga mot
Po shkojnë ndaj mërgimi,
Nga kulmi, nga largimi
Na lenë «lam' tu mirën»
Dhe çajnë hapesirën
I bien erës m' not.

Lark venë për ushqim
E nxijnë qiellin, ngasin
Ethirit sipër shkasin ;
Vjen dbora, dimri i mprehtë
Kërkojnë vênt të nxehtë
Plot shpresë dhe kuxim.

Për gojen pa përtim
Mi dete, male shkojnë ;
Rezikun s' e peshojnë,
Mundim edhe të vojtur.
Se jeta duhet rrojtur
S' ka prêhje as qetim.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Ndë kishë



e roba të râ
Me floke të bardha,
Si burra edhe gra;
Me faqet si dardha,

E Djela u-gdhi
Ndaj kisha lart ngjiten —
Në dorë qirî:
Shënjtorët të ndriten...

Me sytë përposh
Ndaj korat po çapin:
Këtu një djalosh
Tej plaku me stapin.

Dhe plakat me vrap
Afrohen pa fjalë —
Tre kryqe, një çap;
I puthin nga dalë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Shênjtorët për reth
  Të nginjur nga botë,
Një syrin s' e heth ;
  Si muri të ftohtë !

Ze prifti e këndon
  Nxjer meshën t' uruar,
Me radhë i bekon ;
  Kungatën nër duar.

Pas kryqe e qirî
  Mëkatet t' u falen,
Më gjû metanî
  Së bêri mê s' ndalen.

Prej Zotit kërkon
  Si cili për vete —
Një ndjesë mjafton :
  Shpëtim kësaj jete !



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Ditë prêndvere

Dita gdhihet, çel agimi
Derdhet drita por si ar,
Çduket nata, shkon qetimi
Dielli rezet si mburimi
I çon poshtë po si zjar.

Ndriten kodrat, fshati zgjohet
Lumi qiellin pasqyron,
Fusha, bregu ngjyra ndrohet
Fletët dridhen, era ngrohet;
Shkëmbi majën sbardhëllon.

Prej kasolles bagëtija
Fushës dalin për ushqim,
Derës jashtë Bukurija
Kur ndaj kroji, kur ndaj vija
Kêngë dreth me përmallim.

Çunat lozin, vashat qepin
Plakat e nata tjerin lesh,
Nuset shkundin, tundin djepin;
Burrat shatën, pleqtë grepin;
Një mban fjalë, tjetri qesh.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRDITA" SHKODËR

Fushës zbresin tatëpjetë
Punëtorët në mëngjes,
Nëpër arat por si mbletë
Kush me veglë kush me qetë;
Me peqinjtë përmi bres.

Vjen mjesdita, grat' u shpien
Buk' e gjellë me ç u-ndoth,
Ndënë hije redhe shtrihen
Hanë drekë, çlodhen, bien
Pastaj nisin punën mbroth.

Hijes gjethit miza, grera;
Zêr' i zoqve reth tingllon,
Del gjahtori nëpër ferra;
Vjen bariu plot me shqerra;
Bujku çmallet e këndon!

Dita ngryset, vjen pushimi;
Dielli unjet shkon më vênt,
Çduket drita, erdh qetimi
Hêna rezet si mburimi:
I derth poshtë si ërgjênt!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Pamje vjeshte



Shkoj vera
Si hije,
Fryn era
Shi bije.

Lart qielli
Si plumbi,
Shkoj dielli
Na humbi.

S' ka jetë —
Ra brymë
Bar, fletë
Pa frymë.

Rri zogu
Të hajë,
Ce shtogu
Mi majë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM FRASHERI" SHKODER

Ka gojë;
Do jetën,
T' a rojë
Të shkretën!

Gjahtari
Del gjahut;
Druvari
Dru krahut.

Del bujku
Mbleth berrat —
Tej ujku
Nër ferrat!

Lart fshatit
Tingllime....
Reth shtratit:
Dëfrime!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Shtëpia ime



ë njoh shtëpia e ime e mjerë
Të njoh nga muret ngrênë, nxirë,
Të njoh, të njoh ty shumë mirë ;
Se brênda atje kam unë lerë
Dhe sisë atje kam unë pirë.

Dhe nêna atje në djep më tundi
Me kêngë malli trimënore,
Me puthje t' êmbla dashurore,
Më përkëdheli ajo sa mundi
Plot nënëqêshje êngjëllore!

O moj shtëpia e ime e gjorë
Ti që më dhe dëfrimn' e parë,
Ty mêndjes kurrë s' të kam ndarë:
Dhe por si asaj së shênitës korë
Si murgu dergjem duk' të qarë!

Ti m' i përmênt ato kujtimet
T' asaj së shtrenjtës, djalërije ;
Plot endra i dehur prej magjie
Me lodrat, vallet e gëzimet:
Dhe vajn' e fyellit kur bie!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"SHKODËR"

Me sa dëshir' e mall të zjartë
Q' atje vështrimet un' i shtinja!
Prej gazit zemrën dot s' e nginja;
Reth malet, brigjet krye lartë
Posht' arat, kopshtet plot mëllinja!

Sa bukur bregut lindte dielli
Shtëpit' e bardha si shkëlqenin,
Shkëndijë drite si ar kërcenin;
Si vash' e re lart qeshte qielli
Me këngë shpesët reth dëfrenin!

Sa herë ty s' te kam në mëndje
Sa herë malli s' më përtrihet;
Një lot i nxehtë sysh më lihet;
Kur di në ç' shtet je edhe në ç' gjëndje
Sa paqe shpirtit nuk' më shtrihet!

Lendinës, fushës sa her' vinja
Sa gas si foshnjë unë s' ndjeja!
Sa syt' atje sot po t' i ktheja,
Mi bar të shkelnja a po të rinja
Të parën shije s' di në e gjeja!

Mërgim, mërgim qofsh i mallkuar
Për jetë zemrën ti m'a theve,
Në thrime anie m'a këmbeve;
Gjith ëndrat pritmje së shpresuar
Si bishë e egër m' i rëmbeve!

Më duket sikur jam një i huaj
Si jetën t'ime e kam këmbyer!
Lark ritur, helme i ushqyer
Dhe zemër degur duroj e vuaj
Veç në kujtime i mallëngjyer!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Shpesh her' atje mendoj të ndodhem!
Si i huaj i lodhur udhëtimit;
Si plak me shkop që kthen mërgimit,
T'a gjej pak prêhjen e të çlodhem
Me shkelm t' i bije tej trishtimit!

Por... nuk' di jo në qoft se vinja
Të shtrihem prap' atje në dhomë;
Të rri, të los mi bar të njomë,
Një frikë kam se kur të rinja
Mos mar përgjigjien: «Lark, s' të njôh mê!»

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

EJA PRÊNDVERË!



O e bukura prêndverë
O perëndesh' e motit,
Gëzona si nga herë —
Bekimin patsh prej Zotit,
Me sa të mira ke
Me gaze e jet' të re!

Vrapô mê shpejt e çel-u
Hap gjirin t' ênt të plottë,
Si zonjë përkëdhel-u;
Si mbret i math në botë
Përndajna bukuri:
Plot mall e dashuri!

Kurorë lulesh thurr-u
Si vashave dhe djemve;
Me ngjyrat t' tua mburr-u
Q' u-ep lisave dhe nemve.
Dhe prej ç' do lul' e gjeth
Me er' afshi deh-na rreth!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Mi bar, me qiell të lirë,
Ku lulet mbijnë sërë;
Bilbilet ku pa u gdhirë
Këndojnë që të tërë,
Ku jeta cmire s' njeh
Me gas ti pritna atje.

Pra eja o moj prêndverë
Prej dimrit rêndë nxjer-na,
Ballsamin t' ênt me vlerë
Në shpirtet t' onë shtjer-na;
Poshtë rezet derdhi si ar
Dhe mbushna flak' e zjar!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Të puthurit e një nêne

(Prej frëngjishtes)



as një ditë të bukur dua një nat' të kjartë
Qielli të jetë i shtruar me hyj si ar lart atje,
Edhe hêna si ërgjêndi, që del fytyrë-zjartë
T' i përndajë posht rezet përmi botën që fle.

E dua edhe mëngjezin me erën të ballsamosur;
Dhe vesa të shkëlqejë më ç' do bimë si lot,
Zefiri të më puthnjë dua pa një të sosur
Dhe zogu të këndojë nëpër gjeth si nga mot.

Dhe kur t' erret,vjen nata mbushur mellankolie
Që me një frujtje era dridhet plot harmoni;
Me atê zê të kulluar si një zê Perëndie
Dëllëndyshes i a dua të freshtën mellodi.

Dua foshnjën e bukur plot gazi kur rri i zgjua
Me vështrimn' e tij t' êmbël, të dashur, êngjëllor;
Me fjalët pa kuptime kur levis kêmbë e duar'
Me flokt' e tij të lëshuar, hedhur mi krahëror.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
SHKODËR

Po dua ca mê tepër puthjet q' i bên një mêmë
Me atê nënëqeshje sa her' q' e përkëdhel ;
Por dua edhe lutjet q' i bên ajo për mbrêmë
Sa her' e ve të flerë ; kur foshnja syt' i mçel.



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

ARDHJA E DIMRIT

Zunë rehț' edhe po shoshen
Dbora bie me qetim,
Dheu mbulohet në të bardhë
Me një robë plot shkëlqim.

Bien flokët si pambuku
Sërë, sërë e një nga një,
Bêjnë vetulla mi muret;
Ndron fytyrë poshț' ç' do gjë.

Ze fryn era pa pushuar
Del veriu me tërbim,
E ngreh dborën por si pendë
E bën togje me nxitim.

Pylli i çveshur rri i trishtuar
Sikur qan, sikur mban zî,
Drurët tunden krahtë ndehur:
Bêjnë lutje si njeri!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Çduket fusha an' e mb' anë
Në syt' duket por si det,
Përtej lumi ndrit si ërgjëndi
Por si gjarpër rrethon, shket!

Dridhen zoqtë nga të ftohtit
Por si fleta ndënë shi;
Kur foleja majës shelgut
Që t' i mprojë s' ka fuqi!

Në fshat ditën duket heshtje
Sipër tymi veç rrethon;
Për m' at' anë dushku i vogël
Po tunt kryet e vajton!

Her' pushimit zë dëgjohet;
Rëza, kodra shpesh gjëmon,
Hyjn' e dalin njerëzija;
Zë sopate derpëton!

Ndë kasolle plaka e zbardhur
Pranë këndit po tjerr lesh,
Vështron flakën që del zjarrit:
Lark menjtohet... loton shpesh.

Del e reja në dritare
Në gjit foshnjën përkedhel;
Dhë një këngë mjaltë e ëmbël
Duk' e puthur gojës del.

Jashtë çunat hidhen, lozin
Gjer sa urija i largon;
Ndenjur shtratit vash' e bukur
Duke êndur po këndon!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Natën fshati fle në prêhje
Kudo paqe mbretëron,
Nër kasollet ênden êndra :
Shpresë jete që s' shtërron :
. . . . . .

Zunë rehtë prap' të shoshen
Dbora bie me qetim,
Dheu mbulohet në të bardhë
Me një robë plot shkëlqim !



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

LENDINA

Lendinë, ti o lendin' e bukur
që çelesh, qesh si vashë e re
Kur je e mveshur shok më s' ke ;
Si Nuse, Zânë më je dukur
me hijet, mallin ti q' e mfsheh !

Lendin' e gjelbër, lule e shtruar !
me lisat rrotull gjer në qiell,
Pëlqime edh' ênda ti që pjell
Më çmall me puthjet e bekuar
kur erën vala ti m' a sjell !

Nër lisat, bredhat plot me hije
q' i ke kurorë rreth për qark,
Këndojnë zoqtë radhë vark,
Dhe mbushin shpirtin plot maqjije ;
buçasin kênget gjer më lark !

Po sa e bukur je lendinë
kur vesa ze shkëlqen mi bar,
Kur rezet derdhen mu si ar ;
Kur poshtë ti çfaq bukurinë
përpjetë duket flak' e zjarr !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
MARIN BARLETI
SHKODËR

Sa sy të bukur, sy të flaktë
të dashur ti që nuk' i njeh,
Në fjalë dhënë ty afër s' pe;
Kur hënës rezet dritë-paktë
i prëkëdhelen nëpër rê.

O vênt, dhuratë Perëndije
sa shpresë, gaze s' i përshkonj
Nër mentt' e mija kur kujtonj
Aq' êndra, lodra djalërije
kujtime t' êmbla që s' i tregonj!

Kudo në shkeltë kêmba e ime
lendin' e bukur, vênt i dheut t' em,
Ndaj ty gjith mêndjen do t' a kem;
Për lulet, viset plot gëzime:
nga zêmra kêngës do t' j' a them!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

DITË PRILLI

Shkoj dimri, kodrat gjumit zgjohen
Ndrit dielli i zjartë derth risî,
Zefiri fryn dhe rêzët ndrohen ;
Të gjitha mvishen me stolî !

Shih fusha bukur si përtrihet !
Lart qielli i kaltërt êmbël qesh,
Dreth kêngë vajza por sa gdhihet
Plot ênda bota êsht' e mvesht !

Nër lisat edh' ushtimi i erës
Me puthje shkon të përkëdhel,
Reth bari, lulet e prendverës
T' a ndezin zjarrin q' êsht' i mçel !

Bariu mi lëndinë i shtrirë
Me fyell mallin po këndon ;
Plot ênëra vasha plot dëshirë
Me syt' të humbur e përgjon !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Si hargje rezet vala derdhen
Ndë heshtje pylli lehtˈ ushton,
Me ngjyra kodrat, lahen, mverdhen
Kur rezˈ e fundit perëndon!

Së largu tingëll prej këmbore
Tej zë lahutejˈ erën çan;
Sikur një zânë këngëtore
Prej qiellit zbritur zêrin mban!

Të gjitha çelen në prêndverë
Një gjak i ri kullon pa prâ,
Dëshira çfaqen gjith pa-prerë:
Prej një fuqije funt që sˈ ka!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

DITË MAJI



alli shkëlqen
Dita ze gdhihet,
Drita po vjen;
Mjegulla ngrihet.

Flagë kullon;
Mali ngjyrohet
Vesa avullon;
Fusha kthjellohet.

Derdhen mu si ar
Rezet që ndrinë
Këngë me zjar
Poshtë ushëtinë!

Djemtë me gas
Udhës këndojnë;
Çupat më pas
Tufat lëshojnë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Bregut mê lart
Fyell dëgjohet,
Poshtë mi bart:
Qengji gëzohet.

Êmbël tingllon
Dashit këmbora,
Malit kur shkon —
Flokë si dbora.

Mall, dashuri
Fjalë të mfshehta;
Sa bukuri
Mor' t'ungjatjeta!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

MENDIMI

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Mendime qetësije

Shumë herë kur i qettë
Rri mejtonem e gjykonj,
Ç' do me thênë kjo jetë
Për se jam e për se ronj.
Dhe me mêndjen të çvêndosur
Pa një fjalë, pa kuvênt,
Heth vështrimin të pa sosur
Vështgoj rrotull më c' do kênt.
Kërkonj tutje lartësirës
Shoh natyrën gjer më lark;
Mu në funt të hapësirës:
Ç' do që ndodhet rreth për qark.
Si ndë heshtje varrit thellë
Ku s' dëgjohet tingëllim,
Mêndjen t' ime e kam përcjellë
Në të mfshehtat pa mbarim!
Shoh si dielli del e mfshihet
Si mbret lint e perëndon;
Natë bêhet, ditë gdhihet
Pas një nomi që s' ndrushon!
Rezet hargje si lëshohen
Përmi qarket me pëlqim,
Faqe, faqe ato si ndrohen
Si magji, si një ëndërim.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

Një pluhur si ar tej po derdhet
Reh ë bukur i ngjyron,
Një ze e ckuqet, tjatër mverdhet
Ngjyra, ngjyra çfytyron.
Shoh më tutje dhe një derë
Me një dritë plot çkëlqim,
Hapet, mbyllet me një herë
Me shigjetat pa mbarim.
Qielli duket gjith i zjartë
Gjak e flakë si mburon,
Sikur maj' e malit lartë
Zjar vollkani gjith kullon!
Një gjê duket fantasije
Shpirtin sipër t' a vëndos,
Kurrë s' nginjesh kësaj shije
Sa dëshira nuk' t' u sos.
Rredhet t' erren me nga dalë
Bukuria ze humbet,
Derdhet nata vjen si valë
Magji, êndër shpejt u-tret.

Shpresat t' ona kështu janë
Një dëshirë na gëzon,
Bota duket an' e mb' anë
Një prêndverë që s' mbaron.
Endra janë, êndra shkojnë:
Gjith sa ndjeve, gjith sa pe
Ditët t' ona fluturojnë
Gjê në dorë kurrë s' ke.
Jeta êshtë veç një grimë
Lumtësia një tinglim,
Mir' e ndjeme, mir' e dimë:
Po s' që shpresa për ushqim!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Gjygi i dyjtë

Tingëllimë



ë zê trumbetash, kêngë muzikore
Këmbana mijë bukur rreth tingllonin,
Lart qiejtë llamparisnin, zjar lëshonin
Verbim shkëlqimi; një çudi qiellore.

Radhë êngjëjsh vargje dukeshin për dore
Me falje krijetarin adhuronin,
Qithara, hymne veshët t' i derptonin
Një udhë hapej, udhë madhështore.

Ndërtesa tundej, qiejsh pikonin yjtë!
Posht' ngjalleshin të vdekur varrit shtrirë;
Prej vêndit sikur shkisnin malet, pyjtë.

Njeriu si mêntsh trullosur sheh i ngrirë
Si hapet Libri i Jetës, 're vê mirë:
Për 'të arth fundi, arth «Gjygi i Dyjtë».

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Ylli i Zjartë

I

Pika, pika shiu që bini
Por si lotte sysh të qarë
Gjith mejtime êndëra shtini:
Zêmrës s'ime djegur, vrarë.

Pika, pika që pikoni
Por si gur margaritari,
Shpirtin mos m'a përvëloni
Me kujtime që së pari!

Pika, pika mjaft, pushoni
Le të dalë qielli i kjartë,
Qarket, viset i kthjelloni
Qe të duket ylli i zjartë.

II

Ylli i zjartë, ylli i rallë
Që shkëlqen më qiell të lirë,
Nër të tjerët q'është ballë;
Pika pika lam' tu çmirë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Ay hyll që më ndrit mua
Që më ngreh në lartësirë,
Me shpirt, zêmër me se dua ;
Pika pika lam' tu mirë !

Yll i bukur dil nga herë
Kur me mallin jam ndë hirë,
Drita jote paska vlerë :
Pika pika lam' tu mirë !



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Malli i vonuar



Si vala tundet shelgu, bredhi
Shkon era gjethit vërshëllèn ;
Lart diellit reht' i rin' si ledhi :
Posht' reze drite mê s' shkëlqèn.

Gjith avull dheut ngrihet, hapet
Dhe degët unjen me trishtim ;
Del mjegulla si tym përhapet :
Pik pik, si lotte pa mbarim.

Dhe trëndafili qan e lutet
Pekulet bijen posht pa zë ;
Një lot prej shpirtit të çkëputet :
Kur sheh stolia se ç' i ka bê !

Të derdhet vreri, zemra t' nxihet
Si dridhen fletët derdhin lot,
Dhe shpirtit helm sikur i shtrihet :
Sikur êsht natë e s' gdhihet dot !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Jam vet' e ndjeĥem i trisĥtuar
Mejtimet s' rjedĥin një nga një;
Munt malli i em êsĥt i vonuar:
Munt zêmra s' reĥ si gjitĥënjê!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

MALL NATE

Del hêna lëmsh si ar
Lart bregut por si korë,
Me rezet reth kurorë;
Çel buzet qesh si zânë
Me kryet gjith më nj' anë
Dhe faqet plot me zjar!

Heth dritën nëpër gjeth
Gjith hargje edhe shigjeta,
Derth ngjyra faqe-zbeta;
Lot, tundet si fantomë
E sy-êmbël hyn në dhomë
Bên qarke murit reth.

— Haj hênë m' u afrô
Kur shtratit jam i shtirë
Si vashë zemër-mirë;
Mi ballët puth-më nxehtë
Dhe mallin t' em të shkretë
Prej shpirtit m' a largô!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

THËLLÊNZA

Poshtë shkëmbit majë mprehtë
ku përroji gjarpër shkon:
Majë bredhit degë-gjelbër
një thëllênzë po këndon!
— Moj thëllênzë shpes' e bukur
eja poshtë m'u afërô,
Mos u-ruaj, mos kij frikë:
pranë meje pak qëndrô.
S' të mërzitet ketu valle
nëpër gurë, nëpër gjeth,
Ku ze dborë, shi edhe breshër
e gjahtori plumbin heth?
Eja bashkë ku e qettë
jetën t' ênde do t' a shkosh,
Me të ngrêna, paqes, gjumit
si një zonjë t' i a shtrosh!
Leri malet, leri bregjet
mjaft shëtite brî mê brî,
S' i ka hije bukurisë
gjith me trojtje nd' arratî!
Ja shtëpia madhështore
hyj në dhomët ec' u shtrih,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Këndô, luaj si të k'ênda ;
pastaj, zogë bjer' e fli.
Shih sa bukur! ç' roba, shtresa
shih sa gjêrra plot shkëlqim,
Syri çlodhet, shpirti prêhet
ndë të mira pa mbarim!
— S' dua roba, s' dua shtresa
s' dua mure me stoli,
Këtô janë shtëpi-burgje
Të çpërlara me flori!
Atje brênda rron nakari
dhe zilia që të vret;
Atje êndet ligësia:
atje „lumi bêhet det"!
Mure unë, ja, kam malet
shtresë fushët që po i sheh
Stoli: lulet, prozhmet, pyllet:
më ç' do vise bënj folè!
Ditën dielli m' i çel sytë
dhe mburimi m' i freskon,
Natën qielli me kandile
shtrofkën mua m' a ndriton!
Ler' më mua si ç' jam bêrë
një thëllênzë pa shtëpi,
Le të çgryhem ndë natyrë:
të vdes dua ndë liri!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIHRIN BARLETI" S H K O D E R

Lumtësia e shpirtit

S' di kështu pse jam o Zot!
Që qanj dit' e nat' me lot
Edhe më s' qetohem dot.

Zêmra herë më vajton
Edhe shpirti helm kullon
Si mburimi që s' pushon.

Lark nër vise dal kërkonj
Pakë prêhje të ngjëronj;
T' a gjenj gazin t' a pushtonj!

* * *

Têrë botën pa pushim
Që në lindje e perëndim
Vajta e ktheva me shpejtim.

Lumtësinë që t' a gjenj
Hidhërimin t' a çdëfrenj;
Atje shpirtin t' a mbërthenj.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Po një zê kështu më thạ:
Mos u çirr e mos u vrâ
Se i lumtur këtu s' ka.

Se ç' do grimë që po shkon
Jeta çduket, kohạ ndron ;
As kush botën s' trashëgon.

Lumtësî vërtet se ka,
Më thạ zêri që s' u pa,
Veç në vafsh «lâ' e mê lâ'» !



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

TINGËLLIMË

Këndoni djema e ardhmja është e juaj
Risija është një lule, bukuri ;
Gëzoniju tashi në moshën t' uaj
Si edhe prëndvera rreth kur derth maqji.

Dhe gruri fushës korret, bëhet duaj
Ç' do lule çel ndë kohë s' ka se si.
E paktë është jeta ; moti sa një muaj ;
Dëfreni e valle drethni përsëri !

Shkon koha e bukur, vjeshta vjen afrohet,
Ze bryma zbarth mi fletë e gjelbërime ;
Fytyrës s' dheut, si faqe e ngjyrë i ndrohet.

Dhe ju të rinj, me këngë edhe gëzime
Nga dal' bryma mi kryet kur t' u shtrohet
At' her si pleq... dëfreni me kujtime !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

KËNDONJ...

Kur mallit zêmra më lëndohet
prêhje s' shijonj,
A prej njëj ngjarje më trishtohet
unë këndonj!
Një dhêmbje kur më bên te vuaj
s' shoh pik gëzim,
S' kam ndryshe zjarin si t' a shuaj:
veç me këndim.
Kur brênga shpirtin m'a pushtojnë
s' ndjej pak qetim,
S' e gjej shërimin të më shkojnë
veç ndë këndim!
Kur ndë rezik atdhen ndodhet
tym më ç' do mur,
E at' here zemra kurrë s' lodhet
kêngës i a thur!
Kur bukurisë dashurinë
un' i dëshmoj,

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

Dhe të më doj' a t' i mbaj zinë
prapë këndoj...
Ndo gaze qofshin, ndo trishtime
qesh a lotoj,
Ndo këngë gofshin ndo vajtime
unë këndoj!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

NJERIU

Si shket uji kur vjen valë
Si shkon moti me vrapim,
Ditet neve po na shkojnë;
Ndjejmë veten pa gjallim.

Shkojnë vjetet; djalëria
Eshtë një ëndër veç nër mënt —
Sa që ckuqet perëndimi
Prap' agimi rri në kënt.

Shkunden fletët, çvishen fare
Pemët tunden lakuriq,
S' i le koha s' i le moti:
Njëri lindi, tjëtri vdiq!

Shumë e ëmbël është kjo jetë
Se s' mbet kohë për mërzi;
Po shum' herë soje ngopesh:
Se je i lindur si „njeri"!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„NARIN BARETI"
SHKODËR

GJYKIME

I pasur s' jam, s' di
Veç djersë edhe punë,
As hua njeri
Nuk' m' ep, as jap unë.

As arka s' ngarkoj
Me barrë metali,
Po dhe liksh të roj
S' m' a don ideali.

Si ç' di ashtu ronj
Dhe si ç' e desh fati;
Se s' munt të ndryshonj
Kurrgjê unë i ngrati!

Reth meje miq kam
Me fjalë që merrem,
Për ç' do kuvênt jam
Së drejtës i therrem.

Nga zihjet rri larg
Gënjeshtrën s' e dua,
Po s' rroj as për bark
S' mêndoj as si grua!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Të tjerë kush e di
Me mua munt qeshin,
Un' hesht si njerî:
E nuk' u a vê veshin.

Gjithkush bên si di
Pas kutit tij matet,
S' ka qartë, s' ka as mërî,
As fjala mê s' zgjatet.

Ç' mêndove a po ç' the —
Në botë sa s' thohen,
Të gjitha ndën' dhè
Për jetë mbulohen!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

NJËJ ZOGUT...



shpesë që më dukesh trime, e gjallë
Me pêndët ngjyrash që shkëlqejnë,
Që ngjitesh lart, bên redhe shpejt a rrallë
Që mua syrin m'a dëfrejnë;
Rethô, rethô, edhe ngjit-u me nga dalë
Mi reht' e bardha por si dbora;
Me madhështi tej derdhu pa një fjalë
Ku s' ka pushtet as kêmba as dora!

Ethirit ngjit-u shpesë kuximtare
Atje ku tjatër kurrë s' vete,
Ku breshëri edhe shiu s' të trembin fare;
Ku s' sheh përveç së malë, dete...
Atje ku nuk' harrin nakarti cmiri,
— Pësimet botën që e mundojnë;
Ku s' të pyet i ligu e as i miri
Për gjërrat ty që s' të trazojnë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D Ë R

Q' atje së larti, mer prej kthjellësirës,
Me thonjt' e tû të fort' si hekur
Me kraht' e tû si mbret i hapësirës
Pak frymë jete së pa vdekur!
Pak jetë nga të kaltërtit e qiellit
Ca vese lott prej yjve të artë;
Prej rézeve shtryth zjar, fuqi prej diellit
Dhe prej pafundjes erë t' kjartë!

Rembè si munt, e sul-u tatëpjetë!
Zbrit si një mundës duk' u tundur,
E qas-m' u si një miku im i vërtetë
Më fal dhuratën që e ke mundur!
Në trup t' a shtie, forcat të me ngjallen
— Si ç' vesa e natës ngjall ç' do bimë;
Me vrap fuqit' e mija që të çpallen:
Të ngjitem lart si vetëtimë!

Por si avulli të çdukesha përpjetë
Si pênda e lehtë q' e mer era;
Lart të qëndronja — fill të jeshe vetë
Të shkonja lark nga dheu, skëterra!
T' a linja botën, njerëzit si ç' janë
Si bishët e egra le të çirren;
Të tallesha së largu atje më ni' anë:
Të shoh të rremat posht si vdirren!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Çase hidhërimi



e ç' natyrë kam s' di vetë
S' di her' shpirti pse m' helmohet,
S' kam as prêhje, s' jam i qettë;
Rreth trishtimi më qarkohet.

Mar një rugë shkonj largonem
Por si i gjuar prej një bishe;
Herë vêndit rri ndalonem:
Si rri shênjti murit kishe!

E ndjej kohën të vështirë;
Jeta, shpirti të mërzitet —
Sikur qielli lart i lirë
Zuri cipë, mê mos ndritet!

Dita duket muaj i têrë:
Sikur dielli s' do të shkasë
Dritës rehț' i rinë sërë:
Si ca vêtulla pa masë!

Flagë del nga perëndimi
Gjak kullojnë tutje rehtë;
Si tek varret lott vajtimi
Që pikojnë sysh të mfshehtë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Ze del hêna rehve çfaqet
Si kukuth që të mer mênttë,
Plot me rudha mbushur faqet
Si lugat që gjuan dhêntë!

Shoh lart yjtë mezî ndizen
Si kandile pa vaj ngjasin;
Hije nate rreth levizen
Si fantoma syve shkasin!

Hyj në dhomë fare ngrysur
Burg më duket kur shoh muret;
Dhe me kryet të përmbysur:
Njs mejtimi të më çthurret.

Në këtˈ heshtje si të varrit
Zê kêmbanash vjen së largu,
Sikur qarje e një të vrarit
Mˈi çpon veshët por si hargu!

Si ay murgu rri paprerë
Më tryesët i menjtuar,
Veten tˈ ime dukˈ e ndjerë
Si të shkretë, deshpëruar!

Ndë shpirtt helmi derdhet pika
Si ndë shpellët stallaktitët;
Drejt në zemër shkoinë thika
Si vrap plumbi q'i mer ditët!

Ndënë dritë të qiririt
Hap një libr' para meje,
Kërkonj brenda; si hrej hîrit
Zjarr, a dritë pas nje reje!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"NAIM BASHETI"
SHKODER

I shosh radhët, ndjek mejtimet
Trut' i vras me t' e kënduar,
T' i gjej fundin e qëllimet
T' asaj dore q' i ka shkruar!

Një pas tjetrës i kthej fletët
Pa verejtje duk' i gjuar,
Para syve por si mbletët
I shoh sërët gjith radhuar.

Vura gjishtin reflektova
Për njerinë q' e ka bërë;
Se ç' qëllonte s' kupëtova:
Sa q' e shosha gjat' e gjërë!

Shpejt e mbylla, tej e plasa;
Dhe në dorë mar një pëndë,
Por, sa kartës që i u qasa:
Për dy radhë më vij rëndë.

S' kisha pikë qetësije
Ndë trup ndjenja mij' shigjeta;
Shihnja meje rreth një hijë:
E po drîdhesha si fleta.

Krah' të kishe fluturonja
Mirnja vrapnë si pëllumbi;
Hidhërime mos ngjëronja
Të mos ndjenja majë thumbi!

Plagë zemrën e ngjeu, bërë
Kur pësimet e rëmojnë;
Por si guri që bën vërë
Pikat uji kur kullojnë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

T' jesh si shkëmb, ay m' i forti
Zemrën munt t' a kesh sa mali,
Por kur her' të gjuan shorti:
S' të shpëton as kush të fali!

Je si peshku nër rïete
Si luân i zên' në leqe;
Pa fuqi je dhe pa mjete
Të rish kundrë ç' do së keqe!

Janë çase hidhërimi
Që të tundin pa mëshirë;
Esht një luftë kur më trimi
Rallë mundës del i mirë!

Si prej valash kur trazohet
Gjëmon deti nga tërbimi;
Ashtu gjaku s' më qetohet:
S' gjenj dot paqe, vênt shpëtimi!

Lart ngreh duart deshpëruar
I çonj lutje Perëndisë;
Pres si Krishti i kryqëzuar:
T'a zbras kupën vrer e pisë!

Në atë orë, ças mërije
T' isha i zoti, i fuqisë,
Do të mirnja dheun t' a shtije:
Të gremiset tej n' abisse!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Tingëllimë

O, lemëni tek êndërat e mija
Të ngjitem lemëni ndaj qielli i lirë,
Atje ku prêhje, paqe gjej mê mirë
Ku shpirti i em e ka shpëtimn' e tija.

Lark, lark trishtime, të këqija
Lark ju mejtime, s' dua errësirë!
Përhapuni në t' dheut gjërësirë
Edhe udhë bêmëni ndaj lumtësia!

Ah, lumtësi! sa her' s' të kam kërkuar
Si rezet njëj mëngjezi të shëndritur,
Si dritën e një syri të kulluar!

S' di vallë vêndi i yt ku munt të jetë
S' di tendat ti se ku do t' i keshë ngritur:
Që kur të vdes të pakën, t' jem i qettë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Dëshira ime

Mes chers amis, quand je mourrai,
Plantez un saule au cimetière ;
J'aime son feuillage éploré,
La pâleur m'en est douce et chère,
Et son ombre sera legère
A la tombe où je dormirai.
Alfred de Musset.

Pylli, prozhmi ku bên hije
Ku qetimi mbretëron,
Lule e bukur ku po bije;
Er' e malit ku s' pushon.

Atje shokë,-atje dua
Kur të vdes, kur të mbaronj,
Të m' a bêni varrin mua
Që të çlodhem si kërkonj.

Më largoni nga të qarët
Që nër varret s' ka pushim,
Se s' kam punë me të marrët
Që nuk dinë ç' është qetim.

Vaj per mua lotte janë :
Pikat vese në mëngjes,
Kur vjollca qan më nj' anë
Kryet unjur gjer në bres.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Majë kodrës në lendinë,
Afër pyllit plot me lis,
Ku me radhë zoqtë rinë;
Dhe mburimi murmuris!

Pranë ujit të kulluar
Udhëtari ku qëndron,
Ku bariu rri i gëzuar:
Me mall zêmre po këndon!

Këto dua varrit pranë,
Të më qajnë me këndim,
Që u ka falur Nymfa Zânë
Të zbavitin shpirtin t' im.

S' kam dëshirë për vajtime
Po lark Pllutonit të jem;
Ndaj Olympi, nër kthjellime:
Shpirtin t' im dua t' a kem!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

MALLI I NËNËS

Engjëll' i nënës, mall i zëmrës s' ime
Flij i qetuar, flij pa një kujdes,
Për ty mundohem, copë dhe thërime
Për tyn' o shpirt, për tyn' e mjera vdes.

Zogthi i nënës, pëllumb i krahëshkruar
Engjëll i vogël, cop' e trupit t' im,
Nani zog nani, ah, duke kënduar
Dua të ritesh burrë, t' bëhesh trim.

Duke kënduar! syt' i kam plot lote
Un' e mjera për tyn' o djal o bir,
Të kam t' vetëm e mall, dhe shpresa jote
Më mbush më gas, kendoni e më pahir!

Reze qiellore, djelli i jetës s' ime
Nani bir nani, flij mos më trishtô,
Mos daj se nëna xuan, heq mundime;
Hesht, djalë hesht se nëna ty të dô!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHKODËR

Flij, flij! êngjëlli mpronjës po rri pranë
Ay kurrë s' na le ndë fillërim,
Po ndeh krahun pa mas' edhe pa anë;
Të ligun e largon, na ka ndënë mprim.

Zot i fuqive, Ati yn' i vërtetë
Ty o Hyjlindëse Virgjërë Mari,
E përunjët me zemrën vij të nxehtë
Të kërkonj shpëtim, ndihmë, lumëri!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Lutja e çunavet

I

Zot që stise qiellin
E sa na shohin sytë,
Që bêre dhenë, diellin
Si edh' hênën bashk' me hyjtë;
Ty lutje ne të çohim
Se Ty për Zot të njohim,
Që jetën na e dhe
T' a rrojmë përmi dhê.

Me kryet unjur vijmë
Mëshirë të na falësh,
Të lumtur të harrijmë
Dhe ndihmës të na dalësh;

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Mos bijem në mëkate
Jashtë urdhrit, dashjes s' ate.
Dhe ngasjes na shpëtô
Na ndih dhe na bekô.

Se mburje edhe lëvdatë
Për Ty, ne s' i kursejmë,
Për ditë edhe për natë
Ndaj qielli syt' i kthejmë.
Pra hirin T'ênt dhurô-na
Prej ç' do gabim largô-na;
Si një Atë mpronjëtor
Prej fronit T'ênt qiellor!

II

Zot, prit-i lutjet t' ona
Prej shpirtit që t'i çohim;
Pranë êngjëllin dërgô-na
Që rugën drejt t' a shohim.
Se jotja êsht fuqija
Nderimi edhe lavdija;
Dhe, Ty të kemi Mbret:
Të fortë plot pushtet.

Dhurona e mirësitë
Prej qiellit, prej së lartit,
Ndritô-na o Zot me dritë
Si Ti di o mêndje-arti.
Bekimin T'ênt të shenjtë
Dhuraten mê të shtrenjtë,
Të plottë nepna-e sot
Ç' do dit' edhe ç' do mot.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

O shtylla e jetës s' onë
Ndaj Tynë syt' i shtiem;
Na ruaj gjithëmonë
Më gjunjë Ty të biem;
Fuqi më tepër s' kemi
Të mitur, foshnja jemi;
Dhe zemra kaq' na di
Po, fal-na o Perëndi!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Dita e vitit shkollar

(Bërë për shkollën e çupave të Korcës)

I

Një dit' e madhe çkrepi duke u gdhirë
Një diell' i ri mi dhet sikur shkëlqèn,
Natyra rreth përhap një êmbëlsire
Një bukuri dhe gas kudo çdëfrèn.

Kjo dit' e bukur që ardhi plot shkëlqime
Sa ditë e madhe êshtë sot per ne,
Kjo êshtë dita që na mbush gëzime
Dhe shpirtin t' onë lart që na e ngreh!

Të gjitha marin një fytyrë tjetër
Të gjitha ndrohen, mvishen përsëri;
Një gjak i ri kullon ndë tjë të vjetër
Prej qiellit sikur derdhet një rrsî!

Shih drurët rreth si çelen, mbushen pemë,
Shih fushat sa bjellore plot kallinj,
Dhuratat posht si derdhen pa një të remë;
Si merren gjith me punë pleq edhe të rinj!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" KORÇË

Dhe ne si nxênëse, me përurime
Këtê të bukur ditë që ardhi sot,
Fat-mirë q' êshtë dhe për aq' fitime:
Me gas e presim se na i solli plot!

I qofshim Zotit fal' për ç' do të mirë
Atij t' i falemi si një At q' urdhëron,
Ay na ndrit në jetë, derth mëshirë
Ay çpërblèn njeriun për sa punon!

O Perëndi! Ti lartëson njerinë
I dhè fuqi, dhe mêndje për stoli,
I çel dhe ndjenjat; fale madhërinë
Të jetë mbret mi gjithë ç' bëre Ti!

Qofsh i bekuar Zot, Atë i vërtetë
Bekimin T'ênt të shênjtë na dërgô,
Se ty të lutemi sa kemi jetë
Të dalim faqebardhë për ç' far' do!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R



NGJATJETIMI I NXËNËSVE

II

Iqofshim falë Zotit
Për ditën që na pruri
Me nder edhe lavdim,
Kjo dita e mot-motit
Kurorë sot na thuri
Me lule plot shkëlqim.

Gëzim të pa-anë ndjejmë
Ndë zêmër një dëshirë
Për sa fituam ne,
As mundim t' i a çpërblejmë
Të Lartit Atit-mirë
Ndë t'errët që s' na le!

Atij pra adhurime
T' i sjellim ne për ditë
Si një mëshirë plot
Me falje edhe bekime
Për gjithë mirësitë
Që na i fal si Zot.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Si nxênëse të urta
Ne rrokim sot mësimin
Që mêndjen e ndriton,
Nuk' jemi zemër-gurta
Por duam përparimin
Që shpirtin lartëson!

Mësonjësve të ndershme
Urojmë ngjatjetime
Me gjithë zemër sot,
Për punët aq' të vlershme
Këshilla dhe mësime
Që nuk' harrohen dot.

Dhe sa që urdhëruat,
Gëzuar zonja qofshi
Me gjithë zotërinj,
Me ardhjen na nderuat
Pra shumë vjete rrofshi:
Si pleq edhe të rinj!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

E VEJA

III

Si zonjë e madhe isha, me nder e shkova jetën.
Shtëpin' e kisha hapur, i varfri s' dilte bosh;
E drejta më pëlqente, s' e shkelnja të vërtetën
T' i bënj të keqe tjetrit, oh, zemra nuk' m' a thosh!
E vë, pa burrë mbeta — ashtu më qënkej thënë,
Ndë zî t'a shkonja jetën me vojtje dhe durim;
Me pesë foshnja pranë, që Zoti m' i kish dhënë
T' i rit, t' u jap këshilla; mos mbetem për mallkim.
Punova sa që munda, kafshore gojës s' vinja;
Fëmijët t' jenë njerës, mejtonja për mëngjes,
Zilî më kishin bota, nga dora nuk' i hinja;
Tre djem edhe dy çupa, i rita me kujdes!

Kështu mejtonte e mjera, për fatn' e saj që pati
Fëmijët që t' i ritjë për ndihmë për gëzim,
Se pasje tjatër s' kishte, nga burri as nga i âti —
Veç rrojtje me kujdese, dhe vojtje pa pushim!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHTETËRORE
MARIN BARLETI

Fëmijët u-martuan — të k'ênda t' i shëkoje,
Ç' do djalë edhe ç' do çupë më vete kish shtëpi;
Dhe mêma e tyre e varfër mbet fill—kur e vështroje
Më dysh, që fare plakë; ish tretur si qirî!
Atà q' i kishte ritur me djersë dhe mundime
Për 'të s' kujtonin fare, si mêm' e tyre që ish!
Gjer sa e ngriti shpresën; dhe hyri në mejtime
Atyre ajo t' u vejë, mënyrë tjetër s' kish!

Mejtimet keq e grinin, më ç' derë që te zêrë!
Dhe dorës mori shkopin, ndë mê të voglin shkon,
Në sy me lot i lutet — ajo q' e kishte bërë,
Të pshtetjë pakë kryet, të birit i kërkon!
Për fat të keq së mjerës nuk' i u dëgjua zêri!
Se veç ca kohë ndenji — as nukë mbushi mot,
U bê e pa duruar! së resë s' di ç' i bêri
Për ditë me qërtime, nga goja s' reshtnin dot!
E reja kish mësime, një grua plot me dijë;
E vjera gjê nuk' dinte, e thjeshtë pa gjykim,
Dy karaktere kundra, që s' vihen dot më vijë
Përveç kur me mësimin ke bindje edhe durim!
Më kot i thoshte djalit për sa q' i bën e reja,
Por edhe ay ç' t' i bênte? e me një fjal' i tha;
Të vejë ku të dojë! Dhe ngrihet shkon e veja
Mer shkopin prap' në dorë dhe me shëndet i la!

Me radhë i mer të gjithë, s' la derë pa trokitur!
Po një s' kuxoj t'a marë, t'a ketë gjith në kênt,
T' i jetë ndënë urdhër, t'a shohë vatrës shtritur
Për shumë shkake duket, aja më s' gjente vênt
Kudo që vinte e gjora, gjith një pergjigjie mirte
—Tek tjetri shko moj nëne, nuk bën këtu për ty!
Këtu bën shumë ngrohtë; dhe jashtë fët e nxirte,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRDITA" SHKODËR

S' i zbutej fare zêmra, si hâlë e kish në sy!
Dhe tjetri prap' i thoshte: shko nêne ca mê tutje
Këtu bên ftohtë tepër, e mos sëmuresh keq!
Një tjetër: vênt s' më ndodhet, nga zemra të bënj [lutje,
Jam ngushtë po ecë gjetkë, kam mjaft kujdese q' heq!
Dhe plaka mbeti rugës me aqë djem e çupa!
Një copë bukë s' kishte për rrojtje për ushqim,
U-droth prej vrerit tepër, aq' ishte mbushur kupa
Sa ra më gjunjë murga, u lutej me deshprim!

Nga turpi, goj' e botës, të duken zemër-mirë;
Një ditë që të pesë, u mblothnë në kuvênt,
Ç' t' i bêjnë mêmës tyre mos rrije jasht' e shtrirë—
Mëkat për 'tâ mjaft ishte të mos i gjejnë vênt!
Me fjalë dhan' e muar e shoshnë mêndjen shumë,
I vranë trutë tepër, gjer sa q' i dhanë funt;
Të zot:it vetë s' ishin - bij shum' edhe për lumë,
Se ndë spital e shpunë, mê s' gjetnë vênt gjëkunt!
Kur ardhi ora e shkretë, të ndahet nga fëmija
Prej zemrës psherëtiti, një lot nga syt' i ra,
Me krahtë ndehur, zgjatur, ndaj qielli, Perëndija
Me mall i puth e gjora me mallëngjim u tha:
«O bijt' e mij të dashur, që shkoni lark prej meje
Të shkretë që më lini, ah, rini me shëndet,
Se unë sa kam hequr; pa gjumë edhe pa prêhje
Veç juve që t' u ruanj jam gdhirë shumë net!
Dhe s' kisha tjatër pranë të m'apë ngushëllime,
Për sa më ndjente shpirti, sa zemra që më desh,
Përveç se Perëndinë; me shpresë edhe kujtime
E shkova jetën unë, dhe bota nuk' më qesh!
Dhe Zoti ynë i lartë, gjykatës i vërtetë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D R

Që shеh ku êshtë e drejta, që kurrë s' bên gabim,
Nër juvet edhe mua, gjykon si ç' e di vetë
Në dor' e ka fuqinë, kujtdo i jep çpërblim!
Por unë do t' i lutem me shpirtin, zemrën t' ime
Që sa kam vojtur unë, sa ditë mbushur zî,
Mos vuani ju as gjysmë, po qofshi me bekime
Të rroni ju si njerës; të njihni Perëndî!»

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

DRURI I JETËS

IV

Në një vênt të dheut gjêrë
Esht një kopsht si paradhis,
Si në botë mê s' ka shêmbëll
As që ndodhet më ç' do vis.
Bukurin' e ka pa masë
Gjith prêndverë mbretëron,
Drita e diellit e pa sosur
Ngjyra, ngjyra faqet ndron.
Lumënj shkojnë të kulluar
Uji derdhet por si ërgjênt,
Lulet ndrijne plot me ngjyra;
Magji çfaqet më ç' do kênt.
Drurët, pemët më ç' do anë
Tufat, gjethet plot pëlqim
Unjen, tunden me nga dalë
Kur del era sjell frujtim!
Shpesët, bishat ven' e vijnë:
Zogj këndojnë vis më vis,
Zêri i êmbël tinglon bukur
Më ç' do degë, më ç' do lis!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Po ky kopësht i magjepsur
Që ndë botë më s' ka shok,
Me stolitë q' êsht i mveshur
Syt' e mëndjen që t' i rrok,
Brênda ka një gjê të rallë
Që të shtie në çudi.
Që êshtë ballë mi të gjitha —
Dhe habitet ç' do njeri!
Tej në mest në një lëndinë
Një shelk ngrihet gjer më qiell,
Degë-gjêrë, fletë gjelbër
Hijen vala q' e përcjell.
Ky êshtë shelgu, druri i jetës
Që êshte ritur në lavdi,
Dhe që çquhet nga të tjerët:
Si një shênjë, si çudî!
Degët mbushur plot me pemë
Me shkëlqime por si ar
Kush heth sytë, sheh që poshtë:
Ndjen dëshirë, ndjen një zjar!
Gjith sa kanë andej udhë
Vêndit mbeten me habî,
Sikur ndjejnë gjë në zemër
Një të mfshehtë, një fuqî!
Të rinj shkojnë, ngrehin krye
Lart vështrojnë me lakmim,
Ndehin duart, kraht' i zgjatin
'Luten drurit pa pushim:
«Drur' i jetës, drur' i bukur
Drur' i lartë, madhështor,
Unji degët plot me pemë,
Se urija keq na korr!
Unji degët këtej poshtë
Kij mëshirë, ah për ne,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATI" SHKODËR

Nga pak pemë që të marim :
Pemë të arta ti që ke.
Sa të bukura që qënkan ;
Shih si mvaren sërë, vark,
Sa të lumtur do të qemë
Në mos ishin aqë lark!»

Kështu luteshin të rinjtë
Gjith me sytë atje lart ;
Prej dëshirës tyre tepër
As që shkelnin përmi bart!
Kur po prisnin plot urije
T' unjen degët gjer mhërdhè,
Të rrëmbejnë nga ato pemët
Mëndja e tyre që s' u flè,
Fletët dridhen, degët tunden
Dhe përpiqen brî më brî,
Poshtë vjen një zê shum' i ëmbël
Plot mësim për ç' do të rî :
«Bij të dashur, mos nxitohi
S' êshtë koha ; bêni faj!
Durim duhet për ç' do punë
Mos pendohi keq pastaj!
Prisni, prisni në kuptoni
Se këshilla kush dëgjon,
Shum' i lumtur do të jetë
Sa ka jetë sa që rron!
Kush dëshirës s' i di masën
Kush lakmimit s' i vë frè,
S' ka virtyte njerëzis :
As vet-veten nuk e njeh!»
Kështu thotë druri i jetës
Gjith atyreve të rinj,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Me një fjalë të vërtetë
Për të mir' e të këqinj!
Mos kërkoni ato gjêrra
Q' êdhe koha nuk' i jep,
Sepse vijnë, bien vetë
Dita e tyre kur ze çkrep.
Perëndija q' i ka bërë
I ka vënë me qëllim,
Që kur koha të harrijë:
Kujtdo t' jenë për fitim!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

BUKURIA

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

E Bukur' e Dheut

Që lart nga reja ka pikuar !
Shëndrit si gur margaritari
Si pika e vesës e kulluar ;
Agim mëngjezi, dritë âri :
Magji' e prallës pa treguar.

Ndë buzët ngjyrën e qershjive
Ndë syt' të kaltërtit e qiellit,
Ndë leshț' të verdhjit e kallijve ;
Fytyr' e saj si drita e diellit,
Dhe trupi hiri i perëndijve !

Mburim e krua bukurije !
'Saj i unjet madhëria e mbretit,
Kur del, le gjyrmë prej shkëndije ;
E bardhë por si shkumba e detit ;
Ndë pamjet një verbim magjije !

Del soje drita e vërtetë
Fytyra e saj shkëlqen si korë,
Si reze ndrit që prurr gjithçkatë ;
Sikur mban qiellin, yjt' në dorë :
E Bukura êshț e Dheut vetë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "SYMRI N BARLETI"
S H K O D E R

Të gjith i falin shpirt e zemër
Se shêmbëll, shoqe s' ka në botë,
Nër Lulet Lule êsht më emër;
Kushdo q' e sheh s' kuxon të thotë:
Se nuk' êsht êngjëll, por êsht femër!

Luâni i fortë krejit zbutet
Kur hijet i sheh dhe bukurinë;
Dhe murgu shênjtit kur i lutet
Shigjetë e përshkon të zinë:
Si hyll prej qiellit kur çkëputet.

Dhe mbreti qoft' a punëtori
Për 'të shpesh zemra u reh të dyve;
Fetari qoft' a vjershëtori
U-merret mêndja, drita e syve:
Demòn, që gjyqin shpejt t' a mori!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Dashurô!

Shëko lisi si më flet
Fjalë t' êmbla si më ushton,
Degët unj e më thërrèt:
Dashurô, se koha shkon!

Maj' e plepit gjithënjê
Kur tunt kryet më qërton,
Përpjek fletët më çon zê:
Djalë ç' pret e s' dashuron!

Er' e malit me një ushtim
Dhe mburimi që kullon,
Gjith më thonë plot gëzim:
Dashurô, se koha shkon!

Kopshtit vasha që po pret
Si zog pylli që kendon,
Buzë-qeshur më thërrèt,
Djalë ç pret e s' dashurón!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Mua zemra gjithë më reh
Brênda gjaku më valon,
M'a ndes mallin më vê 're:
Dashurô, se kohа shkon!

Ç' do gjê rrotull më pyet
Djalë ç' pret e s' dashuron,
Ditët shkojne, jeta shket;
Dashurô, se kohа shkon!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

MALLI IM

Er' e malit fryn nga dalë
Përmi fushët plot me bar,
Mua malli por si valë
M' a mbush zemrën plot me zjar!

Er' e malit fryn e qettë
Si nga lindij' e perëndim;
Breg, lendinë shohin jetë:
Zoqtë çmallen me këndim.

Me hâ malli për natyrë;
Lisa, plepa në largim...
Po veç malli i asaj fytyrë:
M' a zgjat jetën m' ep gjallim!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Të tâna jan' gëzû...

Por si bishẗë e nalt' e bukur
Kurmi i gjatë si selvi,
Kudo sḧkon ti në të dukur
Përḧap rretḧ nji magjî!

Trëndafili qi mban erë
Uli kryet tatëpjet',
Tuj t' a pâmun me nji ḧerë:
Fytyrën por si mbret.

Kopsḧtit qyqja kur të pout
Tek po rije tuj këndû,
Sytë teje mâ s' i ḧoqi:
Mbet vêndit tuj pusḧû!

Qiellit ḧânëza balosḧe
Qindroj vêndit kur të pâ,
E prej emrit si vogloshe
Ajo zuri e me qâ!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

T' tâna jan' tuj u-mposhtûmun
Syni jot sa q' âsht tuj pâ ;
Dhe me çud jan' tuj kërkumun
Për punën q' âsht tuj ngjâ !

Po kur bashk na jena hasun
Me mallîm tuj u qafû,
Dhe me buzt tuj u përqasun
At' her' : t' tâna jan' gëzû !



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Ndënë dritare

Qisi shiu të bjerë pika
Flluska ngrihen permi ujë,
Bêhet qielli lart rëmujë
Vetëtin sa të mer frika.

Mbrêma vij ndënë dritare —
Pres të dukesh o moj korë,
Qoftë shi a po qoftë dborë
As më trêmbin mua fare.

Sado forcë, fuqi kanë
Dhe gjëmimi dhe rrufeja,
S' më largojnë nga foleja
C' atij zogut q' e ndjej pranë.

Ashtu qênka zêmra e ime
Kur ka mallin për të pjekur,
Duron shumë është si hekur:
S' njeh të liga, s' njeh mundime!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

S' lodhem fare duk' e pritur
Se dritares kur del, çfaqet,
Buzë-qeshur i çel faqet;
Sikur pranë saj jam ngjitur.

— Vashë dil si hên' e plottë
Midis luleve që ke mbjellë,
Hith një lule më përcjellë:
Të qetohem, të fle ngrohtë!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

BUKURIA

Kasolles për mëngjes
Del vasha mveshur hollë
Me gjiret si dy mollë;
Rri anës vijës lahet,
Kur shihet dot më s' mbahet;
Lesht' derdhur gjer në bres.

M' e bukur as më s' ka!
Ndë syt' ajo si njihet
Kur faqet sheh dhe hijet;
Prej gazit qesh e nxehet
E me êndra malli dehet
Si veten shoqe s' pá!

Fryn era leht' ushton!
Dhe vija si pasqyrë
Ndron faqe, ndron fytyrë,
Si pênda dridhet, tundet;
Prej shelgjet gjeth ze shkundet
Hap redhe ku pikon!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARK BARLETI"
SHKODER

Një dridhje zemrës ndjen!
Kur shef se bukurija
I ndrohet rudha e vija;
Kur vetullat si hargje
Dhe leshtë unazash vargje:
Si ç' ishin më s' i gjen!

... Shef trimin tej kur shkon
Sy-zjari plot shigjeta;
Derptime ndjen të mfshehta!
Heth sytë prap' te vija
S' shef gjê; veç hij' e tija —
Qesh nd' ujët... êndëron!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

KUJTIMI I SAJ



elin lulet plot burbuqe
Trëndafili lëshon erë,
Mbushet fusha lulekuqe
Kallî gruri nis të nxjerë.

Mua malli më ka marë
Për natyrë për prëndverë,
Dhe sa syri më ka parë
Prapë s' nginjet nonjë herë.

Por kujtimet nuk' më ndahen
Mëndja e ime nuk' largohet,
Zemrës, lotet kurrë s' lahen:
Kur ajo më mfytyrohet.



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

TRËNDAFILI



rëndafili ndaj mëngjezi
Kur i duket, çfaqet mezi
Dhe hap krahtë,
Kur çel fletët, kur çfaq vlerën
Paradhisit hapi derën :
S' më ze gjumi dit' e natë.

Trëndafili mbrêma herë
Mbyll pekulet që të flerë
Mêntt' e mija
Si zog nate nër dellinja
Duan erën t' i thëthinja ;
Po s' pickoftë gjêmbi i tija !

Trëndafili ku ka çelur
Buza jote e paska vjelur ;
Zemra e ime
Prush e flagë, ze më ndizet
Gjaku brênda më levizet
Plot me êndra edhe pëlqime !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Thëllênza e Lekës



jal' i bukur si ndë prralë
Që në krye e gjer në funt,
Shtat të naltë, sy të gjallë ;
Çun i ritur në katunt.
Një krijesë bukurije ;
Trim i mbarë plot me hije.

Po ç' ka Leka që mejtohet
Gjith i pshtetur mi një gur,
S' i qesh buza, as qetohet
Por as kêngës mê s' j' a thur.
Asaj kênge dashurije
Lart ndaj qielli që të shpie !

Kthehet trimi mbrêmë fare
Fushës punën kur mbaron ;
Ndaj shtëpia "dy dritare"
I heth syt' edhe rënkon !
Për Thëllênzën që i rri mfshehur
Përmi shtresat shtrirë, ndehur.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

Kur shkon rugës ndaj deriçka
Majë kêmbës thumb më thumb,
Heth Thëllênzës me guriçka
I bên shênjë si pëllumb;
Veç fytyrën t' i vështrojë
Zjari i zemrës që t' i shkojë!

Sot ashtu dhe nesër ndryshe —
Endra Lekës shpejt i del.
Se Thëllênzën-dëllëndyshe
Me mall zjari e përkëdhel.
Gjith me fjal' edhe premptime
Për një pritmje me gëzime.

... Nd' atê vênt të parën herë
Ajo dorën kur j' a dha,
Kur prej gazit që kish ndjerë
Një lot faqesh dheut i ra;
Çel një mbimë plot burbuqe:
Trëndafil me lul' të kuqe!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Fli më nge!



Fry moj erë e prêndverës
Fry me mall me ëmbëlsi,
Çel-m'a zemrën përkëdhel-e
Ngjall-m'a shpirtin përsëri.

Ndë lendinë gjelbërore
Kêngë malli dëshëronj,
Têrë ndjenjat, ah, më thonë
Tyn' o êngjëll të adhuronj
Tyn' o êngjëll të adhuronj.

Nata duket e vështirë
Hêna mfshihet nëpër re,
Ti mê s' dukesh ku je vallë
Mêndja mua dot s' më ne!

Nata duket e vështirë
Hêna mfshihet nëpër re,
Flij e dashur fli në paqe
Fli mi lule, fli më nge
Fli mi lule, fli më nge!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
SHKODËR

TINGËLLIMË

Qante Eros-i lott derthte lumit anës
As dielli rezet të arta më s' i a çonte,
Po me trishtim i shtrirë dheut rënkonte;
Si një që vdes në ramjet e këmbanës.

Në shpirt plot helm, se format e Dianës
Më s' dukeshin tek ujët që kullonte,
Veç erë vjeshte shelgjet i trazonte:
Dhe fletët laheshin në vênt të Zânes!

I dukej nat' e zezë jet' e tija;
As sytë s' kishin më shkëlqimn' e zjartë;
Sepse me kohën bashk' i u shojt risija!

Kot Eros-i po priste prap' të kthehet,
Kot e kujtonte trupn' e saj të kjartë:
Se jishin êndra plaku... shpesh që dehet!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
MARIN BARLETI
S H K O D E R

PREJ KATUNDIT



ështrô Kocin si po tundet
Me fustanen klinda bêrë,
Udhës ecën, robës shkundet
Që t' a shohë fshati i têrë.

Ndënë feste sërë sërë
Mban baluket përmi ballë ;
Dreth mustaqet si gjilpërë —
Djal' i bukur, djal' i gjallë.

Anterin' e ka stolisur
Gjith me sumbulla, me lule,
Mëngët, jakën të qendisur,
Vija, vija plot pekule.

Mbathur kalcat pulpës ngjitur
Lidhur dizgat çufka, çufka ;
Me opingat mavë ngritur —
Telatinë plot me bufka.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Mban silahun me pallaska
Me pisqollën të fërkuar;
Edhe unazë Koci paska:
Si një dhëndër i gatuar...

Por as Nonka faj s' ka fare;
Çup' e gjatë si selvia,
Faqe-kuqe si fshatare
Që s' di ç' është djallëzia...

Në pasqyrë leshtë krehur;
Hundë hequr si sqifteri,
Me dy mollë ndë gjit mfshehur —
Afroditë prej mermeri!

Lyer leshkat me vaj afshi
Mban gërshetat krahve zgjidhur,
Me mandilen prej mëndafshi
Majë kokës bukur lidhur.

Kur mëngjezit del në krua
Si sorkadhe shkel nga dalë;
E përveshur si një grua —
Çupë trime më s' ka fjalë!

Po edhe Koci poshtë s' lihet
Se për Nonkën ka dëshirë;
Pranë krojit ay gdhihet;
Që t' a shohë ca më mirë.

Syt' i shtije ndënë vetull
Me mall zjarri duke e parë,
Kur me dorën ndënë sjetull
Kur tek ujët duk u larë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Me vështrime gjithë të mfshehta
Me shmbyllje të qepallës,
Dhe shigjeta majë-mprehta ;
Si ca gjêrra të përrallës !

Po më kot atô shkëndija,
Prush e zjarr pa nonjë flagë,
Se shum' herë dashurija :
Sjell një brengë, hap një plagë.

Mêntt' e tija po baresin
Endrash sytë i arratisen,
Por si fluturat që vdesin
Pas një lule dhe shastisen !

Po edhe portës sa her' dilte
Syt' i mbante tatëpjetë,
Kur i mbyllte, kur i çilte:
Me një ndjenjë, mall të mfshehtë.

Djal' i turpshmë kishte frikë
Gojës fjalë që të nxjerë —
Se zakoni êshtë një çikë
Nom i dytë, dhe ka vlerë.

Koci deshte, Koci priste
Veç një fjalë t' i dëgjoje ;
Gjaku brênda i kërcistej
Për një buzë për një goje.

Kudo vente, mal a fushë
Kur kulloste bagëtinë ;
Sytë, vetullat e gushë :
Ishin êndrat për të zinë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERLETI" SHKODER

Zjari flagë kish lëshuar,
S' ndjente veten n' êsht' e tija ;
Tërë ditën i menjtuar —
Nonka jishte Perëndija !
. . . . . .

Koha shkonte edhe mê s' priste ;
Shpresa Kocit s' i ishte thyer,
Si do puna që të ngjiste :
Nonkën s' kish për t' e këmbyer !

Nonka hiqej çupë odxaku
Por as Kocin s' e harronte,
Me fustanen si zëmbaku
Pranë derës kur po shkonte !

At' i saja 're kish vênë
Çuni portës shpeh se shkonte,
„Mirë dita" q' i kish dhênë
Edhe sy-êmbël q' e shëkonte.

Trim i dukej në të dukur
Syri i mbushej plakut t' onë ;
Djal' i fortë, shtat të bukur —
Njerî mali, si ç' e thonë,

Ay Nonkën dëshëronte
Si pas sërës t' a martojë,
Sa për Kocin as kujtonte
Kêndit dhêndër t' a bekojë ?

Po në botë shumë herë
Ngjasin gjêrra të cuditshme ;
Kjo s' êsht êndër ashtu n' erë
Por êsht punë si e perditshme.

BIBLIOTEKA PUBLIKE „MARIN BARLETI" SHKODËR

Aq' më tepër dashuria
Me fuqin' e saj të mfshehtë
Këput hekura e dreth vija
Dhe zbut zêmra fare lehtë!

Kot as Koci s' u-mundua
Se dëshirën shpejt e mbushi,
Për pak kohë djali u-vlua –
U-shojt flaka, mbeti prushi.

S' di se qysh u-bênë fjalët,
Po një mbrêmë pushka krisi;
U-pajtuan të dy palët:
Pas ca javë e dàsma nisi.

Si ndë dasmët ardhë miqtë
Têrë fshati mori anë,
Dhe të mirët, dhe të liqtë
Në kurorë të gjith' vanë.

Si dy lule të rinjtë ishin
Kishin bashkë dashurinë,
Gra edhe burra zilî u-kishin
Kur u-shihnin bukurinë!

. . . . . .
. . . . . .

Ish i lumtur pun' e madhe
Sikur bota t' isht' e tija!
Gazi i Kocit kësaj radhe
Që veç Nonka edhe shtëpia!

Kur të tjerët ikmin, shkonin
Zenin botën gjak' e gjêrë,
Kamje, pasie të fitonin
Dhe thesarë për të bërë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Kur po shokët pa pushuar
Shkonin, mernin arratinë,
Duke lënë të shkretuar
Si atdhenë edhe shtëpinë,

Vetëm Koci s' u-mejtua
Shum' të holla të fitojë,
Që të lerë fshat e grua ;
Për të huaj të punojë...

Prej katundit s' u-nda kurrë ;
Dhe si trim që s' do të dijë,
Kish shtëpinë si një burrë :
Plot me pasje dhe... fëmijë !



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

KOHA E HUMBUR

Adën' hije të shelgjëve të dêndur
Mi lulet e bardha si zêmbaku,
Sa fjal' dashurije s' kemi êndur
Sa dit' s' shkonin ne me pralla plaku.

Sa her' atje ti s' rinje duke pritur
Atje nd' ato vise plot kujtime.
Me at' fytyrën si hên' e ndritur
Me syt' si dy hyje plot shkëlqime,

Për mezi me mall kur më shtrëngoje
Kur kryet m' i falje si pëlumbi;
Ndë zemrë veç tin' e kupëtoje
Ç' do me thênë koha që na humbi!

Më duket si një êndër natë vere
Kur t' mallëshm me syt të lotuar,
Risîn' e shijonim ne at' here
Si ujin e krojit të kulluar.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHKODER
SHAMAN BARDHI

Shkoj shpejt ajo kohë, më s' vjen kurrë
Prap' s' kthehet, si vesa u-avullua ;
Sot lotet m' u-thanë, sot jam burrë
Ti më s' e kujton, u-bêre grua !



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

SYT' E SAJ



j shumë lart shkëlqejnë
Por si ari të kulluar
Plot zjar e plot magji,
Po as gjê të gjithë s' vlejnë
Sa ay ylli i em i çmuar
Q' i shkon në bukurî!

Sa lule fushës s' janë
Me ngjyra me shkëlqime
Të mveshura stoli,
Po vlerën jo s' e kanë
Si atë të lules s' ime
Që ndrin por si flori!

Dhe sy ka sa të duash
Të bukur, të shkëlqyer
Që dridhesh pas ata,
Po botën që t'la' çjuash
Si syt' e saj të vlyer
Të tjerë, thom se s' ka!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

TINGËLLIMË

Pse më shëkon ndën' vetull duke shkuar
Ç' i heth ato vështrime si shigjeta,
Pse nënëqesh me buzët, ah, të shkreta
Më nj' anë hiqesh, rri gjith' e larguar?

Më dridhet zemra kur të shoh ndryshuar
Kur shoh, ndë shpirt se ndjenja ke të mfshehta;
Dhe sa në syt më s' ndjehet e vërteta
Mundime unë êdhe kam për të çprovuar!

Ti qesh, s' i ndjen të dhemburat e mija
Kur di, se ti më mbushe me êndra, shpresa
Që zemra s' prêhet, zjari q' heth shkëndija!

Pra, qas-u ô êngjëll, dhurô-m'a lumtësinë
Edh' hiret fal-m' i që t' i dha krijesa:
Ashtu patsh zonjë, ndihmë Perëndinë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

NË KRUA

Aga ditë del në krua
Me stomnën shkon në dorë;
Peqinjtë gjer në bres,
Lan kêmbët në përrua
Të bardha por si dborë
Për mbrêma, per mëngjes.

Së largu Nereïdë
Prej detit sikur dolli
Si shkumbë plot shkëlqim;
Si një Karyatidë
Fidias që e polli
Në botë për kujtim.

E trêmbur si sorkadhe,
Prej gjêmbi si e çuar
Heth sytë me habi
Çudi' e saj e madhe
Ish, kur duke u afruar
Po sheh një trim të ri!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRIN BARLETI" SHKODER

Mi kaln' e tij si reja
Fatosh, çudi' e rallë ;
Sy-math, mustaqe-zi,
Vështrimet si rrufeja
J' a heth asaj për ballë
Me syt' sikur e pi !

Plot gas e buzë-qeshur
Ndeh dorën edh' i lutet :
Pak ujë ay i kërkon ;
Dhe rri mi kalë shgjeshur
Sa syri s' i çkëputet
Prej dritës q' e verbon !
. . . . . .

Plot turpit ajo, syve
Me kryet tatëpjetë
Zgjati enën pa një zë ;
Nga dridhjet e të dyve
Derptimet ah, të mfshehtë :
Ra stomna, copë u-bë !..



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Gjumë të lehtë...



lí, fli e bukura vashë urtë e qettë
Si një ëngjëll fli në paqe pa kujdes,
Si flenë trëndafilët gjumn' e lehtë
Si fle vïollca kryet gjer në bres
Si edh' yjt' e zjartë për mëngjes.

Fli vajz' e dashur drita e jetës s' ime,
Patsh gjumn' e lehtë, prëhje e gjithë ç' dô,
Me ëndra përkëdhel-u, me dëfrime
Te i rimti qiell, tek zânat u-lartô
Si shpesë prrallash fluturô!

Gjith' ëndra malli, ëndra dashurije
Lendina lule shtruar ëndërô,
Kurorë trëndafilësh plot magjije
Në botë të pa dukur udhëtô
Nër vise zëmra ku të dô!

... Por, ëndrat kur je gjumit duk' i parë
Pëlqimet e një jete që dëshëron,
Mëntohu vajz' e bukur se më parë
Për ty një zemër ka shpesh që ëndëron
Me lot që qan e të kujton!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHKODRA

Fli prâ, shijoji çaset lumërije
Po mos harrosh, jo! se êndrat që po i sheh,
Me kohë u-çduket drita, bêhën hije
Si qiellshit të kulluar dalin rê:
Dhe prêhje gjumi ti mê s' ke!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Ti me sy të zinj!



moj ti me sy të zij
Q' i ke flokët por si ar,
Eja mezin të t' a mar;
Se po s' ardhe do t' të vij!

O moj ti me sy të zij
Q' i ke buzët si qershi,
Fal-m' a dorën e mos ri:
Se po s' ardhe do t' të vij!

O moj ti me sy të zij
Me vështrimet si rrufè,
Fal-m' i sytë që më shehë:
Se po s' ardhe do t' të vij!

O moj ti me sy të zij
Me ato lule rreth më bres,
Nem një lule të mos vdes:
Se po s' ardhe dot t' të vij!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

TINGËLLIMA

I

Pse gjethi e trëndafili mbajn' aq' erë
Dhe lulet pemve çfaqen me aqë hije?
Pse vesa ndrit si lot sy Perëndije;
Dhe qielli buzë-qesh me gas të ndjerë?

Zefiri ç' ka që krahț' i tunt pa prerë
Muzikë krejt hyjnore lark që bije?
Ç' ka drita tej që po ëndet fije fije
Dhe syri i ditës s' mbyllet që të flerë?

Çudi, magjî a po mrekull është vallë
Të gjitha reth që ngjallen, qeshin bukur
Mos është tjetër botë një ëndrë a pallë?

Jo! tingëlli si i harpës së Orfeut
Dhe bota me shkëlqim më është e dukur
Se ndrit... fytyra e Bukurës së Dheut!

II

Pse malet gjith bucasin, ulërijnë
Posht tundet dheu, vollkanit si i shtyrë;
Pse kodrat duken të ashpra në fytyrë
Dhe pyjet tmeri dridhen, psherëtijnë?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

Pse reĥtë lart përpiqen, çkrepëtijnë
Dĥe perëndimi gjakut mer tej ngjyrë;
Ç' ka botës gjitĥ kjo zî që i ka ĥyrë
Dĥe diellit vetullat si nat' i nxijnë?

Mos êshtë luftë ku armët pa mëshirë
Përpiqen, kryqëzohen si ruferra;
Mos êshtë natë e dita më s' ka gdhirë?

Jo! s' êshte as kushtrimi i Odhyseut
Nuk' êsht as luftë as Ferri, as Skëterra
Po vdes... luâni i ndjerë: Trimi i Dheut!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

TË NDRYSHME

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

„Krimbat" e Shqipërisë

Ka mjaft kohë mjekësia
Q' është ngritur më një shkallë,
Sa çuditet njerëzia:
Dhe ç' do shpes' a kafsh' e gjallë.
Ç' do sëmundje e kërkojnë —
Nxjerin krimbat që e ushqejnë,
Çpikin barra, i ndërtojnë
Për mikrobët şi ç' rëfejnë.
Prej sëmundje së këtillë
Vuan sot dhe Shqipëria;
Po kot bar e ç' do këshillë
Se s' e dhembin mushkëria.
Veç ndë trutë u levrijnë
Jo disave Shqipëtarë,
Brënda krimbat ven' u vijnë.
Sot punojnë si të marrë.
Si më duket kjo sëmundje
Që të vegjël u ka hurë;
Që në krye e gjer në fundje:
Duken shënjat në fytyrë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
SHKODËR

Se nga trutë i u ka zbritur
Majë gjuhës që po flasin,
Ca thërresin si të mitur
Ca si qetë po pëllasin.
Dhe sëmundjen që po kanë
Mos u-marçin disa masa,
E përhapin më ç' do anë
Do t' na mbushin mizash glasa!
S' dimë ç' është për t' u-bërë
Që murtaja të mos hapet,
Shqipërisë gjat 'e gjërë
Mos i a hedhë thonjtë, çapet!

* * *

Tërë bota mir' e dinë
Se „mikrobët" e *kolerës*
Vênt e vatrë kan' Asinë
Si ç' e dinë aqë njerës.
Andaj ruhen lark e ndjekin
Lyen, lahen me shëllirë,
Robat, shtresat mos i prekin;
Zjejnë ujët për t' u-pirë.
Druhen, dridhen nga reziku
Ballë i bëjnë lark të vejë,
Se prish punë, është armiku
I së mbarës ku t'a gjejë.
Dhe ne, duhet sa me parë
Përkujdesje pra të marim,
Të këtijve Shqipëtarë
Shënjë qafës të i u mvarim!
Që t' i njohë bota e tërë
Për sëmundjen që po kanë,
Dhe të dinë ç' i ka bërë
Që i u hiqen gjith më nj' anë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
SHKODËR

Se po lamë hapur vêndin
Nisin shijnë si ndë lêmë,
Hyjnë vatrës, pshtyjnë kêndin:
Si murtaja që sjell gjêmë.
Pa na mbushin muret, shkallat
Më ç' do anë ku do jemi,
Nër shtëpitë dhomat, sallat;
Shkollat, librat, ç' do që kemi!
Pra së bashku t' i përzêmë
Si ca njerës që mejtojmë,
Që të çporren lark ndë nëmë:
Neve pranë s' i afërojmë!
Dhe mos patshim pak shëllirë
Qe t' u lagim gjuhë e gojë,
A ndë plehrat duk' i fshirë;
Marim shkopin ndë nevojë.
Udhën prapë t' u rëfejmë
Tutje detit, mb' anë qiellit,
Ne mikrobet s' i ushqejmë:
Le të venë prapa diellit!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Gomari i mësuar

Një gomar një herë, po gomar prej fisi
Nëpër botë dolli, vajti për mësim,
Pun' e pakët s' ishte, po mjaft ish sa nisi;
Se gomari dihet, s' ka tru për mëndim.

Dhe sa kohë ndenji, mësoj shumë gjërra;
Me të ditur foli si një i math njeri;
Mjaft mësime mori, gjuhët që të têra
Për 'tê ishin lodra: kishte dituri!

Sende shumë dinte, libra kish kënduar —
Têrë ditën s' reshtte kudo hur' e dil,
Sa prej shumë dije, filloseti i çquar
Nga mësimi ish bërë, mëndje karafil!

Shokë si pas mëndjes, bëri jo të paktë
Gjith të trasha priste, ishte plot me mënt,
Për sa kishte parë, syri e kish të flaktë
Me të hijt mburej kurrë s' gjente vênt!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARK BARTI" SHKODËR

Po, i mëntshëm dolli, kafsha na u t'hollua;
Hundën gjith përpjetë, s' fliste me këdô,
Kishte vënë syza; mi krahrort ç' i thua:
Se kish Yj dhe Kryqe, a ç' do gjê na do!

Pak pasqyren s' merte, hundën që t' a shohë
Vallë i ka pak hije, mirë vallë i rri
Kur nxjer gojës fjalët, ndokush mos e njohë
Se pëllèt si kafshë, ngjet si bagëti!

Zu e i zgjati tepër, veshët dhe turrinjtë
Se ato që dinte si pas mëndjes tij;
Dhe të tjerë deshte—pas 'të dhe të rinjtë
Të kërcisnin valle por si ca arrij!

Mëndjet zotit t' ënë, munt shum' i pëlgyen
Gjyrmës pas i vanë, dhe kjo ish çudi;
Po kur hapnë sytë, rrugës prap' u-kthyen
Panë dot se s' bêhet një gomar... njeri!!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

GODIVA

(Pas Alfredit Tenysson)

Dadhëri, mbret i shkëlqyer
Zemër-math, njeri i vyer!
Sa të liga sa mundime
Që m'a çajnë zemrën t' ime
Nukë ndjenj duke vështruar
Aqë vojtje pa u-treguar
Me sa heqin njerëzija
Që t' i fali Perëndija!»
Thosh Godiva e lotuar
Mbretit Karoll të tmeruar.
— Shpirti jyt fare s' zbutet
Kur jot' shoqe vjen të lutet,
Për të mjerët që thërresin
Që po dridhen që po vdesin
Ndë pagesa të ngarkuar
Por si robër të malkuar?
Mbret i dashur, kij mëshirë
Ji m' i butë, ji m' i hirë!
Brënda tretem duk' i parë
Çveshur, sbathur për t' i qarë,
Ndë një rrojtje që s' durohet
Që s' dëftehet, që s' kujtohet!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARUN BARLETI" SHKODËR

Mbreti Karoll duk' u-tundur —
Dorës mjekrën duk' e shkundur,
Pran' i qaset krye-lartë
Edh' i flet me zë të kjartë:
— Oh, Godivë pse trishtohesh
Pse po tretesh, hidhërohesh?
Je e madhe, je e nderuar
E dëgjuar, e gëzuar!
Ty të falet gjindja e tërë —
Mbretëria gjat' e gjërë!
Gjë Godivë s' të dhemp kurrë
Kur ke Karllon mbret e burrë!
Edhe ti si Mbretëreshë
Për 'tà bëj sikur s' ke veshë.
Se një Karoll sa êsht' i gjallë
Palla e tija êshtë pallë.
Tin' atà t' i zesh në gojë
S' ke as punë, s' ke as nevojë!
— Kurrë, kurrë o mbret i vyer
Në këtë zemër s' kam ushqyer,
T' jem e ligë, zemër-gurtë
Kur shoh gjindjen aq' të urtë
Gjith të varfër, të urëtuar
Ndën' një mbret aq' të dëgjuar!
— Po, Godivë n' ke dëshirë
Të shoç popullin të lirë,
Pas pëlqimit t'ênt të jetë
Dhe pagesa të mos ketë,
Veç ahere munt të ngjasë:
Kur e çveshur por si drasë
Ti të dalësh jasht' kaluar!
Dhe qytetin duk' e shkuar,
Pastaj prap' ashtu të kthehesh:
Ndryshe s'mundet, pra mos rehesh!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Kështu foli mbreti i mvrojtur
Si tiran që ish pa u-drojtur.
Brênda hyn me një të qeshur
Mi front shtrihet fare i çgjeshur!
Dhe Godiva si shkëmp mbeti
Ndë trazim si valë deti!...
. . . . . .
. . . . . .
Trumbetarë edhe lajmtarë
Duke rendur, duke ngarë,
Gjith qytetin e lajmuan
Ţek do van' e tek do shkuan.
Se pas dreke sot kaluar
Fare e çveshur, e zbuluar,
Mbretëresha do të dalë
Nga Pallati mi një kalë!
Luten gjindjes, porositin
Nëpër rrugat mos shëtitin,
Po të mbyllen e të mfshihen
Jashtë sytë mos i shtijen,
Se dô popullin t' a shpëtojë
Prej ç' do gjëmë edhe nevojë!
Del e mjera mbretëreshë
Del e çveshur pa të qeshë!
Si purtekë trupi i dridhet
Dhe nga turpi kuspull mblidhet!
Mbajti fjalën, mbajti nderë
Ah, për popullin e mjerë!
Prej pushimit gjith qyteti
Por si i shkretë kudô mbeti.
Ngado heshtje mbretëronte
Ku ajo pô përparonte!
Edhe gurët q'e shëkonin
Vênt të mfshihen sikur donin.

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKRIMORE

Shpesët, kafshët sikur ndjenin;
Se as qentë mê nuk lehnin!
Veç një shtâzë, një shpirt-ndyrë
Që njeriut kish fytyrë,
Pa t' a shohë nuk' durojti
Ajo rrugës kur po shkojti.
Në dritare syrin vuri
Si shpirt-lik e zemër-guri,
Nga një vêrë t' a vështrojë
Ajo pa t' a kupëtojë!
Po një gjyq, oh, gjyq i naltë —
Jashtë nomit kush mos daltë,
Që mundon si shpirt-mizorët
Dhe të liqtë e tradhëtorët;
I pabesi q' u dëftye
Që në kêmbë e gjer në krye,
Sa kaq' herë shpagë gjeti:
Se i verbër atje mbeti!!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Të pi!

I

Daj verëshitës sill të pi!
Të lutem nxir-e butin jashtë,
Këtu m' a verë afër t' i rri
Të pi, të dehem sa për gjashtë
Dhe vëndit të mos luanj.
Zëmrimet s' dua më t' i ndjej!
Me verë t' i mbyt sa të shuhen,
Në gas të qarët do t' a kthej
Mendimë mua nuk' më duhen
Veç etjen le t' a shuanj!

II

Haj verëshitës shtjer' mos rri!
Sa më pëlqen e shkreta verë;
Të çel të bën si më të ri
Të ndizet gjaku me një herë
Të gjitha rrotull qeshin.
Dëshirë kam një çast t' jem mbret!
Ç' do vrer që kam do t' a bëj mjaltë,
Të ronj i lumtur pak mi dhët;
Se nesër dhe do t' jem e baltë
Dhe *breg* do t' a bënj *sheshin!*

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

NGJYRAT

Sa herë ngjyrat para meje i shoh;
Një ndjenjë të veçantë kam për 'tô.
E zeza, për tregim, më shtije tmerr
Sikur me shpirt më duket jam ndë ferr.
Se ngjyra e zezë êsht një zî
Dhe na tregon fatkeqësî.
Të verdhën prapë fare e meprizoj
Sepse êsht një ngjyrë dot që s' e duroj,
Di, se të verdhit gjithënjê
Si shok me vdekjen êshtë një.
Të gjelbrën, thom q' e dua me t' vërtet,
Se ngjyra e saj ndë jetë të thërret —
Ajo kur ngjallet ndjen se ron
Të mbush me shpresë, të shëron.
E kuqja, oh, e shkreta flak' e zjar
Të ndes, e kur e sheh, ërgjënt edhe ar
S' i do, se tepër të pèlqèn
Kudo që çfaqet, ku shkëlqèn.

BIBLIOTEKA POPULLORE "NAIM FRASHËRI" KORÇË

Po për të bardhën, s' dua të kuxonj
Me goj' a po me fjalë t' a kujtonj!
Se tjetër, s' gjendet por si atê
Esht ngjyra që unë vdes për 'tê!
Se ngjyra e bardhë êsht shênja e paqtësisë
Esht ngjyra që i pëlqen dhe Perëndisë;
Dhe kush që e adhuron
Për zemër-bardhë shkon!



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

EPIGONËT

Dë qytet të Perikleut
Tek qëndron kërthiza e dheut
Edhe Athinë që i thonë,
Ku sot qeni s' njeh të zonë,
Ku ka lindur dielli i parë
Dhe Sokrati burri i mbarë,
Perëndijtë ku qëndronin
Kur Olympit fluturonin;
Kêngë drethnin Nymfat, Zânat
Ndënë lisat, ndënë thanat,
Kur mi krahët e Pegasit
Zbrisnin Musat e Parnasit!
Akropoja lart ku ngrihet
Si hyll drite sot që njihet,
Mveshur tempulla të motshmë
Ku sot falen të devotshmë
Têrë Grekët e Moresë
Të së Vjetrës dhe së „Resë"
Atje mblidheshin për ditë
Ndë kështillë Perëndítë
Që bekonin njerëzinë
Dhe përndanin lumtësinë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Poshtë shkêmbit Parthenonit
Nënë tempull t' Erekthjonit
Ku ish rritur Dhiogjeni —
Fillosof një farë „qeni"
Dhe të tjerët.oratorë;
Mvarur qafës me këmborë,
Qytetarët q' i mësonin
Me sa dinin, kupëtonin.
Të shkëlqyer ishin thonë
Solloni me Ksenofonë,
Dhemosthëni me Euripidhë
Dhe të tjerë. . . Thuqidhidhë!
Këta vinin shumë mbarë
Andaj s' janë për t' u sharë;
Këta shkuan e mê s' janë
Që ngaj ardhën andej vanë.
Po sot puna ndodhet ndryshe
O mor plak, o mori gjyshe!
Se ngaj eshtrat që mê s' mbetnë
A nga plehrat që u gjetnë;
U-mbush vëndi me kërpudha
Sa mê s' njihet gjyrma, udha!
Kudo dalin, kudo mbijnë
Farmaq gojës hedhin shtijnë.
Pra kërpudhat se ç' na u-ritnë
Bregut shênjtë se ç' i u-ngjitnë
Reth e rrotull e qarkuan
Sa u-qelpnë u-kundërmuan!

* * *

Pas një nomi një zakoni
Që e ka natur Deukalioni;
Nga kërpudhat që ishin thonë
Na u-puall Grekrit t' onë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKODER MARIN BARLETI

Na u-bênë kafshë-njerës
Si pas fisit, si pas derës.
Mêndje lartër dhe finokë —
Si në botë s' u gjen shokë!
Mê të çquar dipllomatë
Se Pllatonë... Erostratë.
Dhe Sokrati s' ka nevojë
As t' u flasë gjê me gojë.
Plot me mêndje këta janë
Sa të motshmit poshtë i lanë;
Dhe lavdit' atà q' i çquan
Për së prap' i trashëguan!
S' shohin popullin t' a zgjojnë
Punët, vêndin t' a ndërtojnë
Por i kanë mênttë ndryshe:
Si një zogut dëllëndyshe!
S' jan' të zotërit për vete
Me fuqin' e kësaj jete;
Marin pushkën dalin gjahut
Vet' u bijen shpinës, krahut!
Cilësinë mê të parë —
Që s' u vete fare mbarë;
Sot na kanë politikën
Ku përdorin hutën, thikën,
Si kusarë t' udhës s' madhe
Jo si bij t' asaj Helladhe
Që lëvdonen se po janë
Si të poshtër sharllatanë!
Mirë tha Edmond About-i
Se nga Grekët lark, të ruhi.
Pse na qënkan fis barbuti
Syt' e shpirtin prej hajduti!
S' marin kutin që t' a masin
Hundën tyre pa të flasin.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Po gjith me êndra venë, rojnë:
Têrë botën t' a pushtojnë!
Dhe më parë Shqipërinë
Se u shkon udha ndaj Janinë
Pastaj dinë se Epirë
Shpejt e kanë për t' e fshirë!
Më kot s' vanë e u përpoqnë
Plakë-Europës që i a çkoqnë,
Se u thotë Historia:
Têrë bota êsht' ë Greqia!
Dhe na fryhen, dhe na tunden
Si një buall kur hâ krunden!
Andaj hodhë mbuall farë
Që t' u vejë puna mbarë;
Sa edhe sot êsht Shqipërija,
Plot kërpudha të këqija,
Që po hiqen krye e ballë:
Ndë mënyrët... papagallë!

* * *

U bubu more të mjërë
Ç' u ka marë hunda erë
Nga ato plehrat, nga ato baltë—
Perëndija i u a faltë!
Si mbesoni ju sot vallë
Se Shqiptari s' êsht' i gjallë?
Esht' i humbur êsht' i vrekur
Më s' ka ndjenja a êsht prej kekur?
Më s' ka zemër për atdhenë
Po për besë, vec për fenë,
Q' ëndëroni Shqipërinë
Që nde Vlorë e gjer Janinë?
Ecni duart t' i çpërlani
Me ne bukë pastaj hani,

BIBLIOTEKA UBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Se s' ka frikë Shqipërija
Nga ç' do ljepur, nga Grek-dhija!

.

Tyn' or' Jorgo, Jorgo mbreti.
Farë shpresë më s' të mbeti.
Ti ore Jorgo mbreti i parë
Se ç' na gjete ca të marrë,
Kot të vunë ty ndë ballë
Se s' t' a mvarrin kapistallë!
Mer-e shkopin, shëko udhën
Flak-e mollën, hidh-e flludhën
Se s' ke njerës vesh të marin;
Një ngreh kashtën, tjatri barin!
Dhe ty ditët sot t' i nxijnë
Me thonj, dhëmbë po të grijnë;
Pse «kufirit» ti s' ke dalë —
I ke mbajtur gjith me fjalë;
Se me mbretër fis je bërë
Edhe ndë ujët bën një vërë!
Veç hoborin i u a mbushe:
Me zoq shtërgu, me harrushe!
Fajn' i mjerë s' e ke tinë
Qe s' e zgjate pak Greqinë.
Ti s' sheh rrotull se ç' kusarë
Sa dinakë ke, zuzarë?
Po në kartë dheshkrimtare
Ti Greqinë s'e pè fare
Me fytyrën që êsht si dora
Si një lipës që del forra?
Munt këndove ç' tha, i gjori
Ay Sutzo vjershëtori:
«O Athinë vênd i parë
Se ç' ushqeke sot, gomarë!»

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Dhe Bismarku e pat thênë
Nepër shkrimet q' i ka lênë:
Se nga Grekrit gjith sa janë
Veç një vetëm rri më nj' anë
Si m' i nderçmë që sot mbeti,
Dhe ky êshtë: Jorgo mbreti!
Se s' êsht fis a farë Greku;
S' ka turinj, hundë leleku!

De ore mbret Iorgo-bobota
Ashtu nd' erët s' flasin bota.
Zjar po s' bêre, tym s'del jashtë;
Fqinjët shohin, s' hanë kashtë.
Peshin heqin të peshojnë —
Pastaj fjalët që të çpojnë,
S' janë qyqe e as laraska
Si ç' Athina që na paska!
As mêntsh prishur fare s' janë
As si Grekrit zgjebamanë,
Që po tunden e thërresin
Dhe për bukë rrugës vdesin.
Si ca lipës ven' e vijnë
Botës kêmbet i a lëpijnë.
Lehin vetëm rreth shtëpisë
Gardhit s' dalin as kufisë;
Se ku hundët që t' i futin
Shpejt kurrizin j'a u zbutin.
Në i pyet: Pse fjalë shumë?
Dhe në punë pak për lumë?
«E do sëra, politika,
Gjith' na thonë u-rêntë pika!
Po një ditë do të vijë
Prap' Hekadha që të ndrijë,
Si një herë si që moti
Jemi trima, na ndih Zoti;

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Sepse Grek êsht Perëndija
Dhe sa shohim êsht Greqija!
Jemi burra që lëftojmë
Kurrë armiqtë s' i peshojmë,
Syri jynë s' trëmbet fare
Prej ç' do gjindje luftëtare;
Dhe mos mundçim një me shtatë:
Zakon kemi... kthejmë krahtë!»

Zbrit o Zânë Perëndeshë
E Olympit Mbretëreshë
Ti Minervë Mundëtare.
E qytetit Mpronjëtare.
Dhe ti o Zevsi i dëgjuar
Që shigjeta mban nër duar;
Ju që qiejtë lart i tundni
Dhe themelet dheut i shkundni;
Rë që qitni ndënë sjetull
Kur ju mvrejtni sy e vetull,
Vetëtimat që buçasin
Dhe rrufetë që kërcasin!
Dilni prapë si më parë
Ndaj qyteti duke ngarë,
Bregut shênjtë pak qëndroni
Hithni syt' edhe shëkoni:
Ç' burra, trima kini kêndit
Nder q' i sjellin bregut, vêndit.
Atij vêndi plot shkëlqimi
Që s' del kurrë nga kujtimi;
Që habitet bota e têrë
Për ç' do punë q' është bërë!
Po si ujqër çirren, hahen
Si të marrë lyen, lahen;

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

U ka hyrë djallëzija
U-a tret zemrën madhështija!
Edh' Helladhën që u a latë
Sot ka mbetur dorë-thatë.
Emri juaj është shuar
I përqeshur, i mposhtuar!

. . . . . .

Pra së larti mëntt u fryni —
Afër gojën mos e ndyni,
Se po u thatë të vërtetën
Shpejt u a kthejnë dhe ju fletën.
Më s' i u njohin, s' i u peshojnë
Tempull, kishë i u dërmojnë;
Po s' u bëftë ajo që thonë,
E mohojnë edh atë Zonë!
Kështu bëjnë sot Neronët
Mëndje-shkurtër. . . Epigonët!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

VERA

Dil Hênë
Ndaj dera,
Çô zênë
Si shqerra!

Dil çupë
Se ngriva —
Ngrit kupë:
U-piva.

Sa shije
Ka vera!
Esht pije
Për derra

Gëzohet
Pak zëmbra,
Të ngrohet
Dhe thembra.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Fryn era
Vjen nata ;
Nga vera
Se ç' pata !

I dehur
Ku rashë,
Sy-nxehur
Gjê s' pashë.

Mbanj zênë,
Sy mbylla ;
Lart hênë
Si dylla !

Ish vashë
A po êndër ;
Ç' u-pashë :
Si dhêndër !...



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

PËR GJAH

Lyshekët për brezi
Dhe pushkën mi krah,
Pa zbardhur mëngjezi
Të dalim për gjah.

O burra bre shokë
Reth hapur të gjith,
Vênt zini mi tokë
Lart malit më vith.

Thëllênza edhe rosa
Dhi t' egra mjaft ka,
Arrinj, dera, dosa —
Sorkadhe si kâ.

Nosita edhe shkurta
Plot turtuj ndë gjeth,
Verdhashka të urta —
Kot plumbin s' e heth!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Bam, bum! të kërcasë
Drejt plumbi mi 'tô,
Mḫerdḫê sa t' pëllasë;
Mer gjaḫun dḫe shkô.

Me krahtë ngarkuar
Gjith kush në shtëpi,
T' i ḫajë i gëzuar
Për ditë nga tri.

Mësallës t' i shtriḫet
Me verë rush-zî,
Dḫe rrojtjes t' i viḫet:
Me ḫâ edḫe me pî!



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Me kupat plot!

Tok mbledhur në mësallë
Me kupat plot përpara
Me kungujt tej për ballë,
Sa rojmë jemi gjallë:
Me kupat plot përpara!

Të pimë miq e shokë!
Të derdhet vera shkumbë,
T' i bëjmë trutë trokë
Të zbrazet but e okë
Të derdhet vera shkumbë!

Me kupat gjith përpjetë
T' a bëjmë det e lumë,
Të shkojmë dit' e jetë;
Të pijë një sa tetë:
T' a bëjmë det e lumë!

Me valle dhe dëfrime
Me kêngë dhe lahuta,
T' harrojmë ç' do mejtime
Ç' do brenga, hidhërime
Me kêngë dhe lahuta!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

DESHA TË KEM...

Edh' unë desha një shtëpi me vlerë
Me mure të artë, shtresa me stoli,
Të prêhem si një zot, si i math njeri;
Të m' unjet bota, fjalë pa të nxjerë.

Edh' unë desha një arkë si të tjerë
T' a mbush, t' a ngjesh me ërgjênt e me flori,
T' a mbyll, t' a hap e pranë gjith t' i rri;
Të vê dhe zemrën brênda që të flerë!

Kjo êshtë sot fillosofia e jetës!
Ç' të duhen êndrat, barkun që s' e ngjeshin
Ç' të duhet rruga e drejtë e së vërtetës!

Ç' ke ti në qajnë foshnja, pleq e femra,
Ç' ke ti me atà që s' kanë se ç' të mveshin...
Mjaft êsht sa të kënaqet ty me ar zemra!!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

MËSALLA E LËNDËS

	Faqe
Disa fjalë përpara	7

ATDHEU

Drinit	15
Lutja e të humburvet	20
Shqipërisë	22
Pesë qint vjete	24
Betimi mi flamur	26
Në mërgim	28
Gjendja jonë	30
Krorëve tradhëtorë	33
Besa jonë	36
Vlera e atdheut	38
Përralla e plakut	40
Lulja e vetëm	43
Mallëngjim	44
Balashit	47
Varri i harruar	48
Lulekuqeja	50
Lutje Zânës	52
Shqiponja me dy krerë	55
Përpara!	56
Varrit të Skanderbegut	58
Malli i shkretë	60
Bariu i parë	62

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Faqe

Τῇ μητρὶ Ἀλβανίᾳ 64
Çpërblimi 68
Zâni i lahutës 71
Tingëllimë 73
Gjer kur vallë! 74
Të falura 76
Koshtuta... në Shqipëri 77
Sami Pojanit 83
Armët e Skanderbegut 85
Τάφοι ἡρώων 87
Zëri i kryengritësvet 88
Kënga e bashkimit 91
Krujës 93
Kosovës 95
Cilët jemi! 99
Dëshmorëve të kombit 100

NATYRA

Të korrat 103
Përëndim dielli në verë 105
Këndo-na bilbil 107
Vjeshta 109
Shpesët udhëtare 111
Ndë kishë 112
Ditë prëndvere 114
Pamje vjeshte 116
Shtëpia imo 118
Eja prëndverë! 121
Të puthurit e një nëne 123
Ardhja e dimrit 125
Lendina 128
Ditë Prilli 130
Ditë Maji 132

MENDIMI

Mendime qetësije 137
Gjyqi i dyjtë 139
Ylli i zjartë 140
Malli i vonuar 142

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

	Faqe
Mall nate	144
Thëllënza	145
Lumtësia e shpirtit	147
Tingëllimë	149
Këndonj	150
Njeriu	152
Gjykime	153
Njëj zogut	155
Çase hidhërimi	157
Tingëllimë	161
Dëshira ime	162
Malli i nënës	164
Lutja e çunavet	166
Dita e vitit shkollar	169
Ngjatjetimi i nxënësve	171
E veja	173
Druri i jetës	177

BUKURIA

E Bukur' e Dheut	183
Dashurô!	185
Malli im	187
Të tâna jan' gëzû	188
Ndënë dritare	190
Bukuria	192
Kujtimi i saj	194
Trëndafili	195
Thëllënza e Lekës	196
Fli më nge! (adaptim)	198
Tingëllimë	199
Prej katundit	200
Koha e humbur	206
Syt' e saj	208
Tingëllimë	209
Në krua	210
Gjumë të lehtë	212
Ti me sy të zinj!	214
Tingëllima	215

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

TË NDRYSHME

	Faqe
„Krimbat“ e Shqipërisë	219
Gomari i mësuar	222
Godiva	224
Të pi!	228
Ngjyrat	229
Epigonët	231
Vera	239
Per gjah	241
Me kupat plot!	243
Desha të kem	244



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Shpjegim i disâ fjalëve të tekstit

Shqip	Gërqisht	Frêngjisht
Abissë	Ἄβυσσος	Abysse
Agim	Αὐγὴ	Aurore
Anie	Πλοῖον	Vaisseau
Cilësî	Ποιότης	Qualité
Çdukje	Ἔκλειψις	Disparition
Dedikoj	Ἀφιερόνω	je dédie
Derpëtim	Διαπερῶ	je traverse
Derpëtoj	Συγκίνησις,	Commotion
Dëshirë	Πόθος	Désir
Deshpërim	Ἀπελπισία	Désespoir
Devotçëm	Ἀφοσιωμένος	Dévoté
Edukatë	Ἐκπαίδευσις	Education
Epigonët	Οἱ Ἐπίγονοι	Les Épigones
Evollutë	Ἐξέλιξις	Evolution
Ferri	Ὁ Ἅδης	Les enfers
Flamur	Σημαία	Drapeau
Gjeneratë	Γενεὰ	Génération
Harrim	Λήθη	Oubli
Helme	Περικεφαλαία	Casque
Kalonj	Παρέρχομαι	je passe
Kaltërt	Γαλάζιον	Azuré
Këshillë	Συμβουλὴ	Conseil
Kjartë	Καθάριος	Pur
Korë	Εἰκὼν	Image
Koshtutë	Σύνταγμα	Constitution
Kufî	Σύνορον	Frontière
Lajme	Εἴδησις	Information
Mënyrë	Τρόπος	Manière
Meprizim	Ἀπέχθεια	Méprise
Mëshirë	Ἔλεος	Pitié
Mizor	Σκληρόκαρδος	Cruel
Mrekull	Θαῦμα	Miracle
Murg	Ἐρημίτης	Ermite
Nfytyrësî	Φαντασία	Imagination
Pafundja	Τὸ ἄπειρον	L'infini
Përmëndore	Μνημεῖον	Monument

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARK BARLETI" SHKODËR

Premptim	Ὑπόσχεσις	Promesse
Proklamatë	Προκήρυξις	Proclamation
Prozhmi (Geg.)	Λασίδιον	Bocage
Qetim, qetësi	Ἡσυχία, γαλήνη	Tranquillité
Reze	Ἀκτῖνες	Rayons
Reflektoj	Συλλογίζομαι	Je reflécte
Rënime	Ἐρείπια	Ruines
Rietë	Δύκτιον	Filet
Rimtë, i, qiell	Αἴθριος οὐρανός	Clair
Risî	Νεότης	Jeunesse
Shekull	Αἰὼν	Siècle
Shërbesë	Δουλεία	Servitude
Shorti	Τὸ πεπρωμένον	Le sort
Shtatujë	Ανδριὰς	Statue
Shtyllë	Στύλος	Colonne
Tempull	Ναὸς	Temple
Tendë	Σκηνὴ	Tente
T'erri (Geg.)	Σκότος	Ténèbres
Tingëllimë	Σοννέτον	Sonnet
Theror	Θυσία	Sacrifice
Viollcë (manushaqe)	Ἴον	Violette
Vollkan	Ἡφαίστεον	Vulcain
Vullnet	Θέλησις	Volonté
Zânë (Geg.)	Μοῦσα	Muse
«Alma mater» e thênë Latine; Mêm' e të mjerëve	Ἡ μήτηρ τῶν τεθλιμμένων	La mère des opprессés

Nga Kryefytyra

RUBEA VEXILLA NIGRIS ET BICIPITIBUS DISTINCTA AQUILIS GEREBAT SCANDERBEGUS.

Barletius : Historia de vita et gestis Scanderbegi Romae. 1506. Folio XV.

DANS SES ESTENDARS QUI ESTOIENT TOUS ROUGES SCANDERBEG PORTOIT UNE AIGLE NOIRE A DEUX TESTES.

Lavardin : Histoire de Scanderbeg, roy d'Albanie. Paris, 1576. Page 42.

NË FLÂMURET, TË CILËT JSHIN TË GJITHË TË KUQ, SKËNDERBEU KISHTE NJË SHQIPONJË ME DY KRERË.

Barletius edhe Lavardin. Shkrimtarë t'asaj kohe.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE SEKTORI I DEPOZITIMIT

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Impr. GUTENBERG, rue Doamnei, 20. — Bucarest.